



Komuna Suharekë
Municipality of Suhareka

KOMUNA SUHAREKË			
29.06.2023			
KRYETARI			
REÇENJE			
KRYETARI			
REÇENJE			
Numri i Dokumentit	Numri i Aktit	Shkronja e Aktit	Vendi i Aktit
01	016	AD113	2

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT JANAR-QERSHOR 2023



BALI MUHARREMAJ

Email [bali.muharremaj@rks-gov.net]

Qytetarë të nderuar të Suharekës

Ky raport përfshin realizimin e shumë projekteve të cilat janë caktuar sipas Planit të Punes për këtë vit kalendarik, pra për vitin 2023, për periudhën gjashtë mujore Janar-Qershor 2023.

Përmes prezantimit të mëposhtëm, të secilës drejtori dhe sektorëve të caktuara, ju qytetarë të nderuar dhe të interesuar, do të njoftoheni për të dhënat konkrete edhe përmes statistikave, në secilin dikaster dhe sektor në drejtoritë e Komunës së Suharekës.

Përmes njoftimeve publike, rrjeteve sociale, ueb faqes zyrtare, diskutimeve publike, me qytetarë, ne kemi njoftuar ecurinë e vazhdimin e projekteve dhe punëve të përditshme.

Komuna e Suharekës është e përkushtuar që secilit qytetarë ti shërbej me nder e gjithmonë duke respektuar ligjin.

Më poshtë për secilën drejtori gjeni raportet e përgaditura:

Sinqerisht,

Bali Muharremaj – Kryetari I Komunës së Suharekës

Përmbajtja

1. Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë
2. Drejtoria për Kultur, Rini, Sport dhe Mërgatë
3. Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa
4. Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari
5. Drejtoria për Administratë
6. Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër
7. Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
8. Drejtoria për Inspekcion
9. Drejtoria për Arsim
10. Drejtoria për Shëndetsi dhe Mirëqenie Sociale

Sektori i Shërbimeve publike

Gjatë këtij 6 (gjashtë) mujori të vitit 2023, në DSHPME – në Sektorin e Shërbime Publike janë kryer punë të ndryshme që kanë të bëjnë me natyrën e punës së kësaj Drejtorie. Disa nga punët më të rëndësishme në këtë drejtori ishin:

- Pranimi i faturave të shpenzimeve komunale, pranimi i faturave të mallrave dhe shërbimeve, si dhe pranimi i shumë fatura tjera në kuadër të Drejtorisë, po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat e shpenzimeve komunale të Rrymës, Ujit, Telefonit, Mbeturinave.
- Po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat të ndryshme për mallra dhe shërbime brenda sektorit të Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë.
- Kryerja e pagesave për punëtorët e zjarrëfikësive dhe faturave të ndryshme për këtë sektor.
- Inicimi i procedurave minimale me zyrën e Prokurimit, për nevojat e zjarrëfikësive në kuadër të –DSHPME.
- Kontakte të shpeshta telefonike me Keds-in, Hidroregjionin, Ekoregjionin, PTK-në etj, për nevojat e Komunës, të qytetarëve për zgjidhjen e kërkesave të tyre për mes telefonit.
- Caktimi nëpër komisione të ndryshme për nevojat e komunës.
- Përgaditja e kërkesave të KEDS-it, si dhe qytetarëve për pëlqimet konkrete të tyre.
- Realizimi i vizitave në teren për kërkesa të ndryshme (strehim, kanalizim, ujësjellës dhe infrastrukturë), por gjithmonë me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve, Publike, Mjedis dhe Emergjencë.
- Lëshimi i dokumenteve për persona fizikë dhe institucione,
- Përgaditja e planifikimit të buxhetit sipas kërkesave për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë, sipas kërkesës së Zyrtarit Kryesor financiar etj.
- Raportimi i raporteve mujore për qdo muaj për faturat e paguara dhe të papaguara, për zyrtarin Kryesor Financiar të Drejtorisë së Financave.
- Kërkesa të shpeshta për ndryshime të faturave nga operatorët e ndryshëm, në bazë të kërkesës të cilën e bëjmë ne si Drejtori e Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë.
- Takime - konsultime të shpeshta me qytetar, për kërkesat dhe nevojat e tyre.
- Takime–konsultime të shpeshta mes bashkëpunëtorëve dhe Drejtorit për punët e ndryshme në Drejtori.
- Raportime të shpeshta Drejtorit, për shpenzimet e sektorit të zjarrëfikësive, për mirëmbajtjen e veturave, sigurimin e automjeteve, shpenzimet e naftës, si dhe shumë shpenzime tjera të sektorit të zjarrëfikësive.
- Takime dhe kontakte të shpeshta me zyrtarin kryesor financiar-ZKF për nevojat e Drejtorisë.
- Bashkëpunim të ndërsjellë me të gjitha sektorët e Drejtorive e në veqanti me Drejtorinë e Urbanizmit, me Zyrën e Prokurimit, me Drejtorinë e Arsimit (DKA), me Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë e Katastrit e tjera), pastaj me “Hidro-regjionin Jugor” njësia Suharekë “ Eko-regjionin “ njësia Suharekë , KEDS-in , PTK-në etj.

- Deri me tash kanë ardhur në drejtorinë 208 kërkesa të ndryshme, 87 kërkesa janë miratuar, 53 kërkesa të refuzuara, 4 janë deleguar me aktpercjellsa ne drejtori te ndryshme, 60 sosh janë në proces.

Pastrimi i rrugëve lokale, 111,762 m'

Larja e rrugëve lokale dhe trotuareve duke bere larjen e tyre nga mbeturinat, 0

Mirembajtja dhe pastrimi i shesheve, parqeve, shtigjeve të ecjes dhe lapidarëve, 79,289 m2

Pastrimi dhe mirembajtja e gjelbrimit ne varreza, 21,000 m2

Mirembajtja e gjelbrimit ne parqe, sheshe, shtigje te ecjes dhe pergjate brezit rrugor, 76,425 m2

Ujitja e hapsirave te gjelbrimit, luleve dhe drunjeve dekorativ ne te gjitha hapsirat publike, 0

Mirembajtja dhe pastrimi i shtratit te lumit ne zonen urbane, 700 m'

Mirembajtja dhe pastrimi i hapsirave publike (te perbashketa) ne objektet shumebanesore 96 cop

Largimi I mbeturinave shtazore, 30 copë.

Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale, nga ky projekt deri me tani kemi pasur disa intervenime, ku pjesa dermuese e kesaj kontrate ka qenë me kujdestari.

-Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale në Komunë nga bora



Gjithashtu takimet e rregullta pune kanë vazhduar për një performancë dhe punë sa më të mirë të drejtorisë të organizuara nga Drejtori me stafin për koordinimin për përfomancë komunale.





Bashkëpunimi në mes Komunës së Suharekës dhe JICA Japoneze ka vazhduar edhe këtë vit “Projekti për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndosh-Faza e dytë”. Komuna e Suharekës është duke vazhduar në fazën e implementimit të projektit ku ka dërguar rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave (PP4), por e njejta nuk ka kaluar në asamblenë komunale. Kjo rregullore është ndihmuar nga ekipi i JET dhe zyrtarëve komunal, ku mendohet që në muajt në vijim të miratohet.



Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë

Në kuadër të Projektit për Ngritjen e Kapaciteteve në Menaxhimin e Mbeturinave drejt një Shoqërie të Shëndoshë i Ciklit Material-Faza 2 kanë zhvilluar vizitë studimore në Japoni Drejtori dhe zyrtari I lart për menaxhimin e mbeturinave (13-23 qershor 2023) ku:


Qëllimi i vizitës studimore ishte:

Për të kuptuar gjendjen aktuale të Ekonomisë Qarkore të Japonisë

- Ligjeratë për të mësuar mbi gjendjen e administrimit të menaxhimit të mbeturinave në Japoni
- Vizitë në terren në objektet/hapësirat e menaxhimit të mbeturinave në qeveritë lokale japoneze dhe shkëmbim mendimesh.



Vizitë e në kuadër të trajnimit për menaxhimin e mbeturinave duke parë nga afër se si funksionon grumbullimi, transporti, ndarja, riciklimi, djegia e deri te shëndërimi i tyre në energji elektrike si dhe vizitë në katër impiante në qytete të ndryshme të Japonisë.



Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë



Fuqizimi i Veprimit Lokal Klimatik (SLCA)

Komuna Suharekës në partneritet me UNDP dhe Institutin INSI mbas takimit i drejtorive të Urbanizmit dhe Shërbimeve Publike me përfaqësuesit e kompanisë INSI, takim i koordinuar nga Qendra Komunale për Zhvillim të Gjellbër në Suharekë.

Qëllimi i takimit ishte koordinim rreth analizës dhe përcaktimit të pikave të matjes, si proces nismëtar duke synuar cilsinë e të dhënave për zhvillimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm. Hartimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm zbatohet në kuadër të projektit "Fuqizimi i Veprimit Lokal për Klimën", projekt i zbatuar në partneritet me UNDP në Kosovë.



Ku Komuna Suharekës në partneritet me UNDP dhe Institutin INSI, i ka montuar këto paisje për matjen, si proces nismëtar duke synuar cilësnë e të dhënave për zhvillimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm.

Këto paisje do të shërbejnë për matjet e hyrje daljeve në qytet, shpejtesinë mesatare të automjeteve. “Fuqizimi i Veprimit Lokal për Klimën”.



Po ashtu gjatë kësaj periudhe është mbajtur në eventin e Projektit “Fuqizimi i Veprimit Lokal Klimatik (FVLK)”, që shënon progresin e Komunës së Prizrenit dhe Suharekës me 10 maj 2023.

Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë

Ngjarja do të ofrojë një përvojë unike dhe gjithëpërfshirëse për të pranishmit, duke paraqitur rezultatet, raportet dhe planet komunale të zhvilluara me mbështetjen e projektit, duke prezantuar një model të replikimit për komunitet e tjera.



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është duke zhvilluar projektin: "Hartat e rrezikut nga përmblytjet dhe hartat e rrezikut nga vërshimet për të gjitha pellgjet e lumenjve në Kosovë, Flood Risk Maps and Flood

Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë

Hazard Maps for All River Basins in Kosovo”, finacuar nga WBIF (Grant code-WB25-KOS-ENV-02-për sigurimin e të dhënave dhe informacioneve institucionet e përfshira nuk duhet të kërkojnë mjete materiale, pra të dhënat dhe informacionet duhet të jepen pa pagesë), dhe është në fazën e grumbullimit të të dhënave dhe informacioneve në aspektin e resurseve ujore. Andaj për shkakë të skjarimit të të dhënave me ekspertët e projektit Ekspertet kan përzgjedhë komunën e Suharekës vizitë gjithë ditore në drejtoritë e ndryshme të komunës, duke përfshirë departamentet e përfshira me çështje që kanë të bëjnë me mjedisin, shërbimet urbane (kullimi i ujit, furnizimi me ujë, mbeturinat, menaxhimi i ujërave të zeza, etj.), ekonomia në përgjithësi dhe në veçanti ndërmarrjet, banorët e komunës dhe komuna/vendbanime, transport. (30.03.2023).



Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspeksionit bashkë me punëtor komunalë, të rinj vullnetarë dhe qytetarë shënuan Ditën e Tokës me aktivitete të shumta. Është i domosdoshëm kujdesi ndaj natyrës, ambientit ku jetojmë dhe shëndetit. (28.04.2023)



Takime bashkëpunimi kanë vazhduar edhe këtë vit me LMT-austriake, ku u diksutuan shumë çështje lidhur me menaxhimin e emergjencave, ku kërkesë e drejtorisë tonë ishte që të gjindet një formë bashkëfinancimi ose donacioni për një automjet zjarrfikës me shkallë hidraulike gjë për cilin Komuna jonë ende nuk e ka, dhe është tejet i nevojshëm. (23.05.2023)



Me qëllim të realizimit të projekteve në mënyrë sa më efektive bashkëpunimi është edhe me Hidroregjionin Jugor-Njësia Suharekë, ku kemi pas edhe takime pune. (09.06.2023)



Inspektori I preventives së Zjarrit

Edhe këtë vit duke u bazuar ne planin vjetor të punës, periudha gjashtëmujore e ketij viti ka kaluar në kryerjen e punëve të lemisë së parandalimit të zjarrit, të kryerjes të inspektimeve të rregullta,të inspektimeve kontrolluese, daljes në vendin e ngjarjes me rastin e zjarreve,dhe punë tjera të mbrojtjes nga zjarri.

Kontakti me njerëz, puna në teren, me udhëheqës të ndërmarrjeve apo kompanive të ndryshme, përveq rolit inspektues e ka edhe rolin këshillues dhe edukativ, në shërbim të parandalimit të zjarrit, shpëtimit të pasurisë dhe jetës së njerëzve.

Sa i përket zjarreve dhe daljeve në vendin e ngjarjes, duhet potencuar se per dallim nga vitet e meparshme, kemi pasur dy shkaktime te qellimshme te zjarri të një shtepie dhe nje objekti pushues në bjeshken e Bukoshit.Një zjarr i cili ka ndodhur në bazën e asfaltit në zonën industriale, është fikur dhe neutralizuar i cili do të kishte pasoja të mëdha për ambientin dhe objektet përreth.

Në kuadër të senzibilizimit të qytetarëve për masat parandaluese nga zjarri, do të bëjmë shpërndarjen e një Apeli nëpër të gjitha fshatrat e komunës si dhe të ndërmarrjeve të ndryshme që të marrin masat parandaluese nga zjarri në sezonin e verës, duke i përdorur edhe mediat si mjet i rëndësishëm në senzibilizimin dhe parandalimin e zjarrit.Një vend të rëndësishem zen edhe sezoni i korrje shirjes me kontrollimin e autokombajnave mbi gjendjen e tyre teknike,dhe posedimin e pajisjeve zjarrefikese.

Më poshtë do të evidentoj punët të cilat janë kryer në periudhën kohore Janar-Qershor 2023 duke u bazuar në Planin vjetor të punës.

1. Inspektime të rregullta.....	24
2. Në sektorin Publik.....	3
3. Në sektorin privat.....	21
4. Inspektime kontrolluese.....	19
5. Masa të shqiptuara.....	68
6. Aktvendime.....	0
7. Pëlqime ne dok.investig teknik.....	11
8. Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....	9
9. Vërtetime.....	1
10. Goditje rrufeje.....	2
11. Raporte.dhe shkresa tjera.....	8
12 .Raport mbi dëmet e shkaktuara nga erërat në disa fshatra.....	1



Disa fotografi nga inspektimet nëpër objektet shkollore
Kalldaja e nxemjes dhe hidrantet në shkolla



- Sektori për infrastrukturë

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor 2023, sipas procedurave ligjore janë përgatitur dokumentacionet për Projektet Kapitale për vitin fiskal 2023. Janë bërë fillimisht sistematizimi i dokumentacionit të vitit paraprak të projekteve, përgatitje të dokumentacioneve si dhe kërkesa dhe Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve për inicim të procedurave, zotimi i mjeteve si dhe hartimi i projekteve për projektet kapitale të vitit fiskal 2023 dhe atë:

1. Ndertimi i rrugës "Varrezat" në Baqevc .
2. Ndertimi i rrugëve lokale, segment i rrugës „Parajsa”.
3. Ndertimi i rruges lokale "Martiret e Dragaqinës" ne Dragaqinë .
4. Ndertimi i rrugëve lokale „Besim Neziraj" segment , "Jetush Berisha" dhe "sherif Aga" në Gjinoc .
5. Ndertimi i rrugëve lokale në Krushicë të Epërme dhe trotuari ne rrugën „Murat Kadriaj" Krushicë e Epërme .
6. Ndertimi i rrugëve lokale segmenti i rrugës „Rahmanaj" segment i rrugës te Rekalit në Krushicë të Poshtme.
7. Ndertimi i rrugëve lokale „Shadan Gashi", „Komandant Drini"- segment, "Bashkim Kabashi"- segment, "Shtjefen Gjeqovi", "Ismet Kodra"-segment në Leshan.
8. Ndertimi i rrugëve lokale „Afrim Bucaj" segment, „Tahir Sinani" segment, në Luzhnicë.
9. Ndertimi i rrugëve lokale: Rexhep velija", "Molika", "Shaljanët"-segment, "Tafa", "Ilaz Shala", "Gentiana", "Haxhi Shanija", "Avdyl Aga ", "Jetush Shala", dhe "Kovaqi" në Mushtisht.
10. Ndertimi i rrugëve "Selim Fondaj" dhe "Hamdi Gashi" në Peqan .
11. Ndertimi i rrugëve lokale „Adrian Krasniqi" në Popolan
12. Ndertimi i rrugëve lokale „Donika Kastrioti" „Zija Prishtina" dhe „Adem Shabani" në Reshtan.
13. Ndertimi i rrugëve lokale „Rahman Ndrecaj" dhe "Gegaj" në Sallagrazhdë.
14. Ndertimi i rrugëve lokale „Imer Munish Rama" „Livadhet e buta" „UÇK" „Rifat Zenelaj" në Savrovë .
15. Ndertimi i rrugëve lokale, „Marsi i martireve" segment dhe "25 Marsi"- segment në Tërrnje.
16. Ndertimi dhe sanimi i rrugëve lokale " "Sopijë-Vraniq" dhe "Reqan-Bukosh".
17. Ndertimi dhe asfaltimi i unazës në Samadrxhë .
18. Ndertimi i rrugës Peqan i Vogël-Semetisht .

Projektet të cilat janë të kontraktuara në vitin: 2020, 2021 dhe 2022 të cilat janë kontrata shumëvjeqare janë duke u menaxhuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike

Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë

Mjedis dhe Emergjencë dhe punimet janë ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike dhe pas krijimit të kushteve atmosferike, punimet vazhdojnë edhe në vitin 2023.

Si dhe është bërë menaxhimi i projekteve të cilat janë: Projekte me Bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës:

- Asfaltimi i rrugës lokale nga kryqezimi i rrugës Nacionale N25-Grejkoc -Rrafshi i Livadheve
- Ndërtimi i unazës – Krahu i djathtë – Suharekë
- Ndërtimi i rrugës Sopi – Shirokë (Rrethrotillimi Leshan L – 5850 M
- Asfaltimi i rrugës që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi) - (Lagja Zekolli), Suharekë
- Ndertimi i rruges Mushtisht - Verbeshticë - Shtërpcë

Janë pergatitur projektet për aplikim për Grande Qeveritare gjegjësisht për aplikim në:

- Ministrinë e Zhvillimit Rajonal
- Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

Gjatë kësaj periudhe është punuar në bashkëpunim me UNDP, në projektin “Fuqizimi i veprimit lokal për klimën”, i cili mbështetet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), Komuna e Suharekës dhe Komuna e Prizrenit.

Poashtu janë bërë vizita të punimeve të cilat janë duke u zhvilluar në teren si dhe vizita sipas kërkesave të qytetarëve.

Përgatitja e referencave për punët e kryera sipas kontratave, të kërkuara nga Operatorët Ekonomik.

Sektori për Mjedis

Përmes kësaj shkrese ju raportojmë se Zyrtari për Mbrojtje të Mjedisit gjatë muajve të lartpërmendur të 01.01.2023-26.06.2023 ka kryer aktivitete të cilat kanë qenë të parapara me kontratë dhe sipas përshkrimit të vendit të punës si dhe detyra tjera shtesë jasht përshkrimit të vendit të punës.

Zyrtari për mbrojtje të mjedisit kryesisht është marrë me:

- Përgjegje në shkresa të ndryshme mjedisore, mvarësisht nga karakteri i tyre.
- Përcjellje të proceseve dhe planeve të ndryshme me karakter mjedisor.
- Dalje në teren për lëndë të caktuara dhe monitorim të projekteve.
- Përgaditja e LMK-ve sipas kërkesave të palëve , ku janë regjistruar 6 LMK.(Tri të përfunduara)
- Përgaditja e Pelqimeve në parim sipas kërkesave, ku janë regjistruar 2 pëlqime (2 të përfunduara)

Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë

Menaxhimi i mbeturinave

Në kuader të menaxhimit të mbeturinave, zyrtari nga ky sektor ka raportuar në Agjencionin për menaxhimin e mbeturinave, ku për herë të parë në procedurë të rregullt ON-Line, në AMMK.

Po ashtu, nga Grandi i performances, Komuna e Suharekës ka përfituar 558 kontinjerë 120L, të cilat janë duke u shpërndarë për kryesi të fshatrave të komunes sonë.

Momenti i pranimit-dorëzimit të kontinjerëve 120L



Stoku i kontinjerëve



-Sektori për Emergjencë

Në pjesën e parë të këtij viti është dhuruar një donacion shumë i arsyeshëm nga Vëllezërit Gegaj nga Studençani që jetojnë dhe punojnë në Gjermani. Ata Njesisë së Zjarrëfiksëve në Suharekë ia kanë dhuruar një kombibus, ku Kryetari Muharremaj dhe drejtori Shabani i falenderuan jashtëzakonisht shumë pasi që ky donacion është i një rëndësie tejet të veçantë për komunën tonë



Raporti gjashtë mujor i NJPZSH për vitin 2023

Raport i intervenimeve 01.01.2023 - 26.06.2023

Realizimi i numrit të përgjithshëm të interven, struktura e zjarreve dhe int.tjera Janar-Qershor 2023													
2023	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbeimeve	Aksidentet e rrugore	Vërs him e	Të rej sh	Të lënduar			Të vdeku r		
								z j .	q yt .	to t	z j .	q yt .	t o t
Janar	10	7	1	0	1	1	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	13	10	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	19	15	0	3	0	0	0	0	1	1	0	0	0
Prill	18	10	1	2	4	0	1	0	5	5	0	0	0
Maj	13	3	4	5	1	0	0	0	0	0	0	0	0
Qersho r	13	7	4	1	1	0	0	0	5	5	0	0	0
Gjithsej të	86	52	10	14	7	1	1	0	1	1	0	0	0

Ju faleminderit për mirëkuptim!

Sinqerisht!
DREJTORI:
Enver Shabani

Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë gjatë këtyre muajve ka realizuar aktivitetet e më poshtme të ndaranë bazë të sektorëve. Poashtu vlen të theksohen vështirësit e shfaqura në realizimin e detyrave dhe obligimeve të drejtorisë tonë.

DKRSM-ja ka bërë takime pune me Drejtor të Drejtorive përkatëse të komunave fqinje, me të cilat shkëmbyem idet dhe përvojat tona për një menaxhim më të sukseshëm.

Gjatë këtij tre mujori janë mbajtur takime me kolegjiunin e Drejtorëve të DKRS me iniciative nga Asociacioni Komunave.

Janë mbajtur takimet për performancë vazhdimisht, duke shqyrtuar raportin e vitit të fundit si dhe duke punuar për një raport për performancë më të mire për këtë vit.

Në fillim të këtij viti janë shpërndarë mirënjohje nga Lidhja Rajonale e Futbollit – Prizren, për sportistët e Komunës sonë.

Nënshkrimi i Kontratës Sociale me USAID, ku program artistik dhe koktej u organizua nga DKRSM.

Rregullimi i nyjeve sanitare në bibliotekë, muze dhe në palestër.

Është bërë pranimi i kërkesave, ankesave, njoftimeve, faturave dhe shqyrtimi i tyre.

Takime me OJQ, klube sportive e qytetarë janë mbajtur pothuajse çdo ditë.

Është përfunduar raporti përfundimtar i OJQ-ve për vitin 2022, i kërkuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit.

Vizita nga Ambasadorja Nancy Soderberg, Drejtoreshë e NDI, ku në atë takim u diskutua mbi avancimin e barazisë gjinore dhe integrimin e qasjes gjithëpërfshirëse në politikbërje dhe në vendimmarrje. Si rezultat i këtij takimi u formua një mekanizëm për çështjet e lartpërmendura, ku pjesë e këtij mekanizmi edhe DKRSM do të ketë përfaqësuesit e saj.

Vendosja e solarëve në Bibliotekën e qytetit “Hajdin Berish” nga UNDP.

Puntori me Un Women Kosova, për buxhetimin gjinor.

Vizit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Stuttgart, ku aty takuam Udhëheqësen e Konsullatës znj. Lumturie Lipoveci dhe me Konsullin Gramoz Berisha. Gjatë këtij takimi diskutuam për vështirësit e Shoqatave Kulturore dhe të rinjët kosovarë që jetojnë në Stuttgart dhe për ofrimin e kushteve dhe mundësive për të zhvilluar aktivitet në gjuhën shqipe.

Furnizimi me libra shqip në Bibliotekën e qytetit të Fellbach në Gjermani. Në Bibliotekë u pritëm nga znj. Solveig Scheider, Udhëheqëse e Bibliotekës, së cilës dhe ja dhuruam kontingjentin me libra.

Festimi i Ditës së Nënës në Fellbach të Gjermanis, me grat shqiptare, që jetojnë dhe punojnë atje. Takime të vazhdueshme me USAID-Kosovën në kuadër të Kontratës Sociale, për projektin “Trajnim për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara”.

Është punuar për plotësim-ndryshimin në rregulloren për subvencione, në pjesën e DKRSM-së.

Takime të vazhdueshme me ojq-të dhe klubet sportive.

Përrurimi i qendrës rekreative për persona me Sindromën Down dhe Autizëm “Duje”.

Përrurimi i këndit të leximit për fëmijë dhe këndit për persona me aftësi të kufizuara në Bibliotekën e Qytetit “Hajdin Berisha”.

Vizita e ish kryetarit të komunës së Fellbach-ut z. Christof Palm, dhe organizimi i ceremonisë së nënshkrimit ku ky i fundit u shpall Qytetar Nderi i Komunës së Suharekës.

U mbajtën takime të vazhdueshme për organizimin e Karnevaleve Golden Eagle.

Sektori i Kulturës

Gjatë këtij gjashtë mujori të parë të vitit, sektori i kulturës ka zhvilluar aktivitete të ndryshme. Me 15 Shkurt u shënuar dita e Flamurti Ashkali, ku kjo festë u mbështet nga DKRSM-ja me një program kulturor-edukativ i mbajtur nga fëmijët e këtij komuniteti si dhe një darkë ku pjesëmarrës ishin përfaqësues nga komuniteti ashkali dhe përfaqësues nga institucionet e komunës etj.

17 Shkurti “Dita e Pavarësisë së Kosovës” këtë vit u shënuar me anë të homazheve dhe dekormit të qytetit dhe lapidareve me flamuj.

Dita e Gruas u shënuar me një tavolinë diskutimi e mbështetur edhe nga OSCE, me temën “Qasja e barabartë në pronë dhe drejta e trashëgimisë për gratë dhe burrat në komunën e Suharekës”. Vizita e profesorëve dhe studentëve të artit nga New York dhe punëtorja një javore me të rinjtë e Komunës së Suharekës ku u zhvilluan aftësitë për animacion video, produksion dhe art interaktiv. Ekspozita të ndryshme personale nga artistët tanë.

Akademi përkujtimore për dëshmorët Milazim Kiqina dhe Enver Bytyqi, ku gjatë kësaj akademie u promovua edhe libri kushtuar dëshmorit Milazim Kiqina, me autor Beqar Kiqina.

Homazhe për nder të dëshmorëve, në datën e rënjes të secilit prej tyre.

Vizitë në bashkinë e Kavajës për nder të ditës së rënjes Dëshmor të Indrot Carës.

Organizimi i javës së pastrime me pjesëmarrës nga të gjitha fushat, kultura, sporti, rinia dhe përfaqësues të ndryshëm nga shoqëria civile.

Promovimi i katalogut për arkeologji në Suharekë, katalog ky i financuar nga DKRSM-ja.

Hapja e ekspozitës nga Kunstvereid Fellbach, ku pjesë e kësaj ekspozite me punime të tyre ishin edhe piktorët nga Suhareka, Refki Gollopi, Bardhyl Bejtullahu, Fatos Kabashi, Liridon Gashi. Organizimi i festës “FC Ballkani – Kampion”.

U mbajt Pranvera Poetike edhe këtë vit. Krijues nga të gjitha trojet shqiptare u bashkuan në qytetin e Suharekës për të prezantuar krijimet e tyre.

Manifestimi i Ditës së Clirimit dhe Ditës së Dëshmorëve në Suharekë. Dita e 13 Qershorit ka filluar me homazhe tek parku i Dëshmorëve, pastaj ka vazhduar me akademinë përkujtimore në bibliotekën e qytetit, ku edhe u ndan cmimet dhe dekoratat për nder të ditës së 13 Qershorit. Në Muzeun e qytetit është bërë pranim-dorëzimi i Vendimit të bashkimit të dy njësive të UCK-së, “Qeliku 50” dhe “Lisi” në një komandë. Më tutje dita ka vazhduar me zbulimin e gurit dhe pllakës së këtij

Vendimi në fashatin Studencan, ku edhe është nënshkruar ky Vendim. Marshi i Veteranëve të UCK-së edhe këtë vit u realizua në pjesëmarrje masive. Dita u përmbyll me koncertin festiv për 13 Qershor në sheshin e qytetit.

Promovimi i librit “Këngët e Shekullit Kallkan” nga autorja Ilirjana Baraliu-Lladrovci. Homazhe për nderë të dëshmorëve, në data e rënjes të secilit prej tyre.

Spektori i Sportit

Me 26 Shkurt në qytetin e Istogut është mbajtur Kampionati i tretë i Kosovës në Lojën me Kapuçë e organizuar nga Klubi Alpin Podguri, nën patronatin e Federatës së Lojrave dhe Sporteve Tradicionale të Kosovës. Pjesëmarrës nga komuna e Suharekës ishin 5 persona të moshës së shtyer së bashku me shoqatën për trashëgimi kulturore “Plisi”. DKRSM-ja i ka mbështetur duke i siguruar transportin.

Shoqata “Sporti Shkollor” e cila mbështetet nga DKRSM-ja ka mbajtur garat komunale në basketboll për shkollat fillore dhe të mesme.

Shoqata “Sporti Shkollor” gjithashtu ka organizuar garat regjionale në basketboll për regjionin e Prizrenit për shkollat fillore dhe të mesme, në të dyjat kategorit.

Shpallja kampion e FC Ballkanit dhe organizimi i ndeshjes së fundit.

Dita Olimpikë në Suharekë u shënua me qindra nxënës dhe fëmijë të qytetit tonë.

Spektori i Rinisë

Instituti Cilësor për Hulumtime, Analiza dhe Trajnime ka mbajtur trajnimin e radhës në Komunën e Suharekës. Këto trajnime kanë qenë me fokus të veçantë për orjentim në karrierë për treg adekuat të punës, këshillim për krijimin e profilit profesional dhe trajnime për shkathtësi punësimi dhe të sipërmarrjes, në kuadër të projektit “Ngritja e kapaciteteve të të rinjve përmes trajnimeve profesionale dhe orjentimit në karrierë”.

Democracy for Development ka mbajtur sallonin e diskutimit në Komunën e Suharekës, me temën “Ngritja e kapaciteteve tek të rinjtë e Suharekës – sa janë aktivë në proceset e avokimit”.

Spektori i Mërgatës

Spektori i mërgatës ka filluar përgaditjet për ditët e Diasporës “Diafest” për vitin 2023. Është mbajtur takimi i parë, ku është diskutuar rreth formimit të këshillit organizativ.

Takimet me kolegjiunin e Diasporës nga MPJD, ku edhe u diskutua për organizimet që do të bëhen për nder të diasporës.

Këshilli organizativ tashmë ka arritur në përfundim të përpilimit të agjendës për ditët e diasporës.

Biblioteka

Gjatë muajit Janar numri i lexuesëve në salla ishte 312. Libra të lexuara ishin: Në sektorin e fëmijëve të regjistruar 148 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 258 copë. Kurse në sektorin e të rriturve të regjistruar 79 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 170 copë.

Muaji Shkurt numri i lexuesve në salla ka arritur në 297. Libra të lexuara ishin: Në sektorin e fëmijëve të regjistruar 146 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 383 copë. Kurse në sektorin e të rriturve të regjistruar 110 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 287 copë.

Kurse gjatë muajit Mars numri i lexuesve në salla ishte 187. Libra të lexuara ishin: Në sektorin e fëmijëve të regjistruar 53 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 349 copë. Kurse në sektorin e të rriturve të regjistruar 27 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 254 copë.

Muaji Prill, numri i lexuesve në salla ka arritur në 182. Libra të lexuara ishin: Në sektorin e fëmijëve të regjistruar 57 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 296 copë. Kurse në sektorin e të rriturve të regjistruar 16 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 224 copë.

Muaji Maj, numri i lexuesve në salla ka arritur në 201. Libra të lexuara ishin: Në sektorin e fëmijëve të regjistruar 22 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 349 copë. Kurse në sektorin e të rriturve të regjistruar 17 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 217 copë.

Muaji Qershor, numri i lexuesve në salla ka arritur në 229. Libra të lexuara ishin: Në sektorin e fëmijëve të regjistruar 4 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 179 copë. Kurse në sektorin e të rriturve të regjistruar 12 libra që janë marrë në shfrytëzim, ndërrimi i librave 184 copë.

Gjithashtu gjatë kësaj kohe është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me MKRS për paurimin e bibliotekës me tituj të rinjë në vlerë prej 6,451.00€.

Muzeu

Gjatë këtyre muajve janë mbajtur takime me Asociacionin e Komunave me fokus të trashëgimis kulturore dhe monumenteve kulturore.

Vizitorët në muze gjatë kësaj periudhe nuk janë të shumtë në numër, por interesimi për vizitat në muze nuk ndalen. Vizitorët më të shpesht janë fëmijët e shkollave fillore dhe atyre të mesme, gjithashtu edhe studiuesit të cilët kanë nevojë për informata shtesë sa i përket trashëgimis kulturore të qytetit tonë.

Shkollat fillore kanë vazhduar me vizitat në Muzeun e qytetit në kuadër të Ditës së Clirimit dhe Ditës së Dëshmorëve.

Palestra Sportive “13 Qershori”

Gjatë periudhës raportuese në Palestrën Sportive “13 Qershori” janë zhvilluar shumë aktivitete sportive ku përfshihen seanca stërvitore për klubet dhe lojë. Klubet të cilat zhvillojnë aktivitet në

palestër janë: KB “Ylli”, U-12, U-16, U-18; Studenqani, KB “Theranda”, KV “Gjinoci”, KV “Theranda”, KB “Tirana”, KB “Theranda”, “Qeliku”, “Puma”, KB “Prizreni”.

Të bashkangjitura në këtë raport do të gjeni edhe disa fotografi të aktiviteteve të Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, në tre mujin e parë të viti 2023.



Akademia përkujtimore dhe promovimi i librit për dëshmorin Milazim Kiqina.



Shpërndarja e mirënjohjeve nga Lidhja Rajonale e Futbollit – Prizren.



Trajnimi i të rinjve nga iChat.




Salloni i diskutimit me të rinjt nga D4D.



Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me MKRS-në për furnizimin me libra në bibliotekat komunale.



Garat regionale në basketboll nga Sporti Shkollor.



Puntoria e artit nga profesorët dhe studentët nga New York.



Ekspozita personale e Drizana Elshanit për gjetjet e artefakteve arkeologjike ne Komunën e Suharekës.




Promovimi i Katalogut të Arkeologjisë së Suharekës



Takim me Un Women Kosova.



Vizita në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Stuttgart.



Dorëzimi i kontigjentit me libra shqip në Bibliotekën e Qytetit të Fellbach-ut.



Vizitat në instutucionet e qytetit të Fellbach-ut në Gjermani.



Festa e Nënës në Fellbach të Gjermanisë.



Hapja e ekspozitës së artistëve tanë të Suharekës në Fellbach.



Plotësim-ndryshimi i Rregullores për Subvencione. Vizit nga grupi i Off Road Xtrem.



Përrurimi i Qendrës Rekrative për persona me Sindromën Down dhe Autizëm "Duje".



Pranvera Poetike në Suharekë.



Homazhe në fshatin Savrovë.



Përurimi i këndit për fëmijë në Bibliotekën e Qytetit.



Manifestimi i Ditës së Clirimit dhe Ditës së Dëshmorëve në Suharekë.



Dita e përkujtimit të Dëshmorit të Kombit Indrit Cara.



Java e pastrimit në Suharekë.

Sektori për Ekonomi, Buxhet dhe Financa;

- Janë faturuar (2967) biznese me vlere prej (580,648.50 €).
- Gjithashtu janë faturuar (148) shrytëzues të pronës komunale në vlerë prej (179,983.45 €).
- Gjatë kësaj periudhe kanë bërë kërkesë (170) biznese për zbritje të Taksës në Aktivitet në vlerë totale të stornuar prej (-53,956.00 €).
- Në këtë periudhë janë lëshuar (6596) fletëpagesa për regjistrim të automjeteve e që vlera totale e tyre është (69,055.00 €).
- Janë lëshuar (2051) vërtetime dhe (73) çertifikata të ndryshme nga zyrtarët për shërbim të qytetarëve,
- Gjatë kësaj periudhe kemi dërguar gjithësej (152) vërejtje të para dhe te (130) vërejtje të dyta për borgjet e akumuluar të shfrytëzuesve të pronave komunale
- Ne qendrën e regjistrimit të biznesit deri me datë 23/06/2023 janë regjistruar (53) biznese individuale, (80) SHPK , (150) modifikime te ndryshme , janë shuar (23) biznese si dhe janë shqyrtuar (146) kerkesa te bizneseve për informata të ndryshme.

Zyra e Thesarit;

- Nga fillimi i vitit deri më 23/06/2023 janë Çertifikuar dhe Aprovuar pagesa në vlerë 1,528,752.23 € nga të gjitha programet e Komunës së Suharekës.
- Të gjitha këto pagesa ,pas Çertifikimit dhe Arovimit janë sistemuar në (22) regjistrator dhe janë arkivuar në Arkivin Financiar të KK në Suharekë.

Zyra për Regjistrimin e Pasurisë;

- Totali i regjistrimit të pasurisë deri me date 23/06/2023 është (335,837,043.87 €) i pasurive kapitale ndërsa i pasurive jo kapitale (vlera nën 1000.00 €) është (2,781,432.90 €).

Sektori i Tatimit në Pronë;

- Janë faturuar dhe dërguar tek tatimpaguesit (14,637) fatura të pronës së paluejtshme.

- Janë shqyrtuar (429) ankesa të tatimpaguesve në të gjithë teritorin e Komunës së Suharekës.
- Regjistrime të reja të objekteve këtë gjashtëmuor eshte (179) si dhe (59) modifikime te objekteve .
- Të hyrat ngaTatimi në Pronë deri me tani janë;(613,304.33 €).
- Gjatë kësaj periudhe kemi dërguar gjithsej (/////) letërkujtesa për borgjet e akumuluarra për përsoneat fizik dhe juridik.

Të hyrat vetanake të realizuara deri me datë 23/06/2023;

- Të hyrat ngaTatimi në Pronë -----(613,304.33 €) ose 48 % te palnifikimit vjetor
- Të hyrat nga Taksa në Aktivitet----- (101,194.88 €) ose 63 % te palnifikimit vjetor
- Të hyrat nga Renta dhe Qiraja ----- (86,244.28 €) ose 0.61 % te palnifikimit vjetor
- Të hyrat nga taksa e regjistrimit të automjeteve----- (69,055.00 €) ose 49 % te palnifikimit vjetor
- Totali i përgjithshëm i të hyrave vetanak pa dënime---(1,220,963.26 €) ose 56 % te palnifikimit vjetor
- Total të hyrat në gjashtëmuorin e I-rë të vitit 2023 me dënime (1,318,402.26 €)

Përshkrimi i shkurtër i aktiviteteve për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023

Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari gjatë gjashtë mujave të parë të vitit 2023 ka vazhduar punën me angazhime maksimal në realizimin e obligimve dhe detyrave me të cilat ngarkohët në sektorët e saj. Gjithashtu edhe sfida dhe problem të shfaqura gjatë këtyre mujave.

Ka filluar puna në teren tek shumica e projekteve kapitale të parapara për vitin 2023.

Aktualisht është duke u punuar në këto projekte kapitale;

1. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore për Bujqësi dhe Pylltari.
2. Ndërtimi i infrastrukturës për turizem në bjeshkën e Vraniqit.
3. Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqet bujqësore në Komunë.
4. Furnizimi dhe Ndërtimi i Serave.

Kurse në procedurë tenderuese është projekti;

1. Ndërtimi i vendkampingjeve turistike në Mushtisht dhe shtigjet e ecjës.

Kurse në këtë periudhë ka përfunduar projekti “Ndërtimi i sistemit të ujitës për sipërfaqet bujqësore në Komunë – kanali hapur, faza e dytë, projekt i vitit 2022, ka përfunduar në muajin Shkurt 2023. Projekti është realizuar në fshatin Samadraxhë

SUBVENCIONET

Në kuadër të projektetve të realizuar me Subvencione si Drejtori për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, kemi bërë subvencionimin e qumshtit me 0.03 cent për fermerët blegoral. Në fillim të këtij viti kemi hapur thirrjen për aplikim për subvencionim të qumshtit për 6 mujorin e 2-të të vitit 2022, ku kanë aplikuar gjithsej 69 fermerë dhe nga ta 68 fermerë kanë përfituar nga ky subvencionim i Drejtorisë për BZHRP.

Ky subvencionim do të vazhdojë ku pas muajit qershor hapim thirrjen për 6 mujorin e parë të vitit 2023.

Kemi shpërndarë edhe 58 spërkatëse për fermerët, projekt i vitit 2023.

Projekt tjetër nga Subvencionet e Drejtorisë për BZHRP është

1. **Furnizimi me mekanizëm Bujqësor**

1. Spërkatëse
2. Motokultivator
3. Maqinë për qethjen e deleve

Tek ky projekt kemi përfunduar thirrjen dhe kemi nisur procedurat tenderuese dhe gjatë muajit korrik presim ta realizojmë si projekt.

Përfitues të këtij projekti do të jenë 142 fermer me Motokultivator, 75 me spërkatëse dhe 40 me makineri për qethje të deleve, vlera e këtij projekti është 99, 670.00 €

Nga Subvencionet e Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari është edhe projekti "Furnizimi dhe montimi i Serave"

Ky projekt ka filluar dhe është në realizim e sipër, ku përfitues do të jenë 67 fermerë të Komunës së Suharekës me tre lloje të sipërfaqeve;

1. 5 Sera me nga 500 m²
2. 5 Sera me nga 200 m²
3. 57 Sera me nga 100 m²

Vlera e projektit "Furnizimi dhe montimi i Serave" është 128,613.00 €.

Bashkfinancim me IADK

Kemi nënshkruar marrvjeshe bashkëfinancimi me IADK për periudhen 2023-2025 për realizimn e projektit "Përmirsimi i punësimit dhe mundësive për gjenerimin e të ardhurave në zonat rurale të Kosovës.

Poashtu kemi mbajtur session infomues për këtë projekt në sallën e Kuvendit Komunal.

Poashtu është hapurr thirrja nga kjo marrveshje ku për këtë vit pritet të përfitojnë 10 fermerë në vlerë 3000 euro mbështetje nga kjo marrveshje bashkfinancimi. Komisioni i ADK së bashku me një anëtar të Drejtorisë BZHRP kanë bërë vlersimin e aplikacioneve dhe kanë bërë përzgjedhjen e përfituesve të kësaj thirrje.

Ky projekt bashkfinancimi me IADK pritet të implementohet gjatë muajit Korrik.

Pagesat Direkte – Subvencione

Kemi përfundu me sukses fazen e aplikimit për Pagesa Direkte – Subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ku kanë aplikuar në këtë thirrje 1265 fermerë të Suharekës.

Si Drejtori kemi pasur volum të shtur të punës, kemi rritur stafin, kemi zgjatur orarin e punës deri në ora 18:00 poashtu edhe të shtunëve dhe të dielave në 2 vikende kemi punuar.

Pjesmarrje në puntori të ndryshme

Kemi pasur takime me organizata të ndryshme edhe vendore edhe ndërkombëtare.

Kemi marrur pjes në puntorinë për trajimin e qeneve endacak.

Takim me Shoqatën e Gjahtarëve “Theranda”

Takim me të gjithë Drejtorët e Bujqësisë në nivel në Ministrisë së Bujqësisë.

Vizitë në Rahovec tek Departamenti i Vreshtarisë dhe Verarisë të Ministrisë së Bujqësisë, ku kemi bërë marrveshje për hapjen e 4 rrugëve fushore në Suharekë.

Pjesmarrje në tryezën e organizuar nga OSBE në Prevallë.

Pjesmarrje në puntorinë e organizuar nga Caritas Zvicëran.

Vizita në teren

Drejtoria e Bujqësisë ka pasur vazhdimisht vizita në teren në shumicën e fshatrave të Komunës së Suharekës.

Vizitë në teren në Njëpërbisht, Budakovë, Sallagrazhdë, Samadraxhë, Studençan, Peqan, Leshan, Reshtan, Maqitevë, Sllapuzhan, Mohlan, Suharekë, Gjinoc, Krushicë, Greikoc, Savrovë, Reqan si dhe shumicën e fshatrave të Suharekës, Luzhnicë, Javor.

Stafi i Drejtorisë ka bërë vlerësimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore

Këshila për fermer dhe udhëzime për subvencione për bujqësi, blegtori.

Stafi i drejtorisë ka dal në teren ku ka pasur kërkesa për vlersim të dëmeve dhe ka bërë raporte të detajuar varsisht prej dëmeve që ka hasur në teren.

SEKTORI I PYLLTARISË

Kemi pranuar 1 kërkesë për damkosje në pyje private për plepa dru teknik.

Tekniku i APK-së në pyje private ka damkosur 1674.35m³ dru zjarri dhe 204.3m³ dru teknik ku gjithsej ka damkosur 1878.65m³ dru në pyje private.

Tekniku i DBZHRP në Suharekë në pyje private ka vulosur 198.32 m³ dru zjarri dhe 14m³ dru teknik ku gjithsej ka vulosur 212.32m³ në pyje private dhe ka lëshuar 149 fletëpërcjellje për këtë masë drusore për destinacion të caktuar.

Janë derguar në gjykatë 45 fletë paraqitje kundervajtëse për 84.32m³ dru për damtuesit e pyjeve.

Janë derguar në gjykatë për vepër penale 11 fletë paraqitje për 26.17m³ dru për damtuesit e pyjeve ku prej tyre 5 fletëparaqitje janë për uzurpim të pronës së APK-së.

Nga gjykata kanë ardhur 75 aktvendime dhe aktgjykime për damtuesit e pyjeve ku 75 damtues janë denuar në vlerë 15600 € ku mesatarja e dënimit për një damtues ka qenë 208€ 4 damtues janë denuar me kushtë ,9 damtues me qortim dhe pezulluar nga gjykata 13 fletëparaqitje.

Janë konfiskuar 44.18m³dru nga damtuesit ilegal.

Në depon grumbulluese në Shirokë kemi 152.83.m³ dru të konfiskuara nga damtuesit ilegal.

Me kërkesen e Policisë kemi bërë 3 vlersime të damëve në pyje private me komision në Maqitev, Krushicë e eperme dhe Bukosh.

Kemi marrë plane operative për mbrojtjen e pyjeve nga damtuesit ilegal në orët e hershme të mengjesit dhe në mbrëmje me përkrahjen e policisë.

Në njesin menagjuese Rakopeq në vendin e quajtur Stanet e Bukoshit APK ka damkosur 433m³ dru ahu për prerje të cilët dru kanë me u pre gjatë këti viti.

Në njesin menagjuese Caralev –Biraq APK ka damkosur 21m³ pishë të cilat janë përfshi nga zjarri viteve të kaluara të cilat kanë me u pre gjatë këti viti.

Në vazhdim po paraqes me foto ilustrim disa nga aktivitetet gjashtë mujorin e parë 2023.



Gjatë shpërndarjës së Mekanizmit Bujqësor. 58 Spërkatëse 400 L për fermerët e Komunës së Suharekës.



Gjatë vizitës në fshatin nëpërbisht tek vëllezërit femer Isa dhe Afrim Hoti, të cilët kanë 1.5 ha me sere si dhe shumë kultura të tjera lavërtare në fuhsë të hapur.



**Projekti “Ndërtimi i sistemit të ujitjës për sipërfaqet bujqësore – Kanali i hapur.
Punimet janë realizuar në fshatin Samadrxhë**



Takimi me Kryetarin e Komunës Bali Muharremaj dhe Komandatin e Policisë në Suharekë Afrim Sylaj me stafin e pylltarisë. Për të rritur kapacitetet dhe angazhimin në mbrojtjen e pyjeve.



Vizitë bletareve në fshatin Papaz.





**Gjatë realizimit të projektit “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Bujqësi dhe Pylltari”
Foto gjatë realizimit të punimeve në fshatin Vraniq**



Në fshatin Dvoran tek fermeri Jetmir Aliaj, i cili në fermën e tij ka 15 lop qumshtore dhe 15 vica.



Gjatë vikendit, faza e aplikimit për Pagesa Direkte – Subvencione

Drejtoria për Administratë

Ky raport paraqet punën e Drejtorisë për Administratës në periudhën e gjashtëmuorit të parë të vitit 2023 (Janar – Qershor, 2023). Raporti paraqet aktivitetet dhe punën e Drejtorisë, sipas fushës së përgjegjësiive ligjore, të bazuar në planin vjetor të punës për vitin 2023. Drejtoria e administratës, në kuadër të fushë veprimtarisë së saj ushtron dhe është përgjegjëse për: Ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera Komunale. Bënë ofrimin e shërbimeve administrative, për qytetarët e Komunës së Suharekës, në kuadër të kompetencavevetanake apo të deleguara ligjore të saj. Përgjegjësitë e administratës:

Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera Komunale të Drejtorisë së Administratës përfshijnë: Zbaton dhe bënë regjistrimin dhe mbajtjen e evidencës së materialit zyrtar që pranohet dhe dorëzohet nga zyra e arkivit të administratës së Komunës, si dhe arkivimin e lëndës arkivore dhe kujdesi për ruajtjen e sajë, dhe kujdesi për ruajtjen e akteve materiale të administratës (librat amë, kartotekat, protokollet, regjistrat, etj)

Ofron të gjitha format e shërbimeve dhe të ndihmës juridike për qytetarët, përfshirë regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtrësive të tyre dhe bënë raportimin për kryerjen e lëndëve administrative në përputhje me afatet ligjore.

Është përgjegjëse dhe kujdeset për ofrimin e shërbimeve postare për nevojat e organeve Komunale dhe organeve të administratës Komunale .

Ushtron dhe menaxhon me fushën e logjistikës, duke përfshirë menaxhimin dhe kujdesin për automjetet, titullar pronësor i të cilave është Komuna e Suharekës.

Organizon dhe kujdeset për mirëmbajtjen e objekteve të administratës Komunale, duke përfshirë organizimin e shërbimeve të sigurimit për këto objekte.

Ushtron të gjitha punët rreth përkujdesjes dhe mirëmbajtjes së teknologjisë informative dhe avancimit të saj për nevoja zyrtare.

Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.

Për të realizuar detyrat dhe përgjegjësit të cilat burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe kompetencat e deleguara natyrisht kemi mbajtur takime të rregullta me shefa të sektorëve si dhe stafin përgjegjës për ti bashkërenduar punët sipas planifikimit për vitin 2023.

Si drejtori kemi paraqitur planin e punës si dhe planin e prokurimit, deri më tani mundë të themi se e kemi realizuar 50% planin e prokurimit, ku kemi zhvilluar procedurat sipas planit.

Si drejtori pas pranimin të qarkores së pare jemi angazhuar në hartimin e Qarkores Buxhetore, ku kemi paraqitur prioritete dhe projektet tona për periudhën 2023-2026.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Administratës është e organizuar në këta sektorë:

1. **Sektori i Gjendjes Civile**
2. **Sektori për Shërbime të Përbashkëta**
3. **Sektori i Arkivës**
4. **Sektori kundër Diskriminimit**

1. Sektori i Gjendjes Civile

Gjendja Civile është pushtet i deleguar nga niveli qendror, që vepron në kuadër të Komunave ARC/MBP (Agjencia e Regjistrimit Civil/Ministria e Punëve të Brendshme)

Sektori i Gjendje Civile lëshon këto dokumente i në vijim: Certifikatat e gjendjes civile, regjistrimet e lindjeve, certifikatat e lindjes, certifikata zëvendësuese e lindjes, certifikata e kurorëzimit, certifikatëzëvendësuese e kurorëzimit, certifikatat e vdekjes, certifikatat e vendbanimit, certifikatë e jetës në bashkësi familjar, certifikatat mbi statusin martesore, regjistrimi I fëmijës të gjetur – aktvendimit të qendrës për punë sociale ose aktgjykimit vlerëshëm, regjistrimet e më vonshme të lindjeve, regjistrimi i fëmijëve të lindur në botën e jashtme, lidhja e martesave- kurorëzimi, kurorëzimi me shtetas të huaj, regjistrimet e martesave të bëra jashtë Kosovës.

Në kuadër të Gjendjes Civile janë në funksion dy E-Kioskave për shërbim të qytetareve 24/7 për dokumentet si: Certifikatë e lindjes, Ekstrakti i Lindjes, Certifikatë e Martesës, Certifikatë e Vendbanimit, Certifikatë e Shtetësisë, Certifikatë e Vdekjes.

Prioritet i Drejtorisë për Administratë mbetet ofrimi i shërbimeve në mënyrë korrekt, transparente dhe në kohë sa më të shpejt të mundshëm, për të cilën vlerësojmë që ja kemi arritur.

Për këtë periudhë gjithsej janë lëshuar këto dokumente:

Numri i kërkesave për certifikata të GJC sipas zyrtarit regjistruar

01/01/2023 - 23/06/2023

shyhrete.morina

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e lindjes	55	1,753	0	1,808
Certifikata e vdekjes	3	304	0	307
Certifikata e Martesës	20	690	0	710
Certifikata e vendbanimit	13	269	0	282
Certifikata e Shtetësisë	0	19	0	19
Ekstrakti i lindjes	42	2,486	0	2,528
Certifikata e statusit martesor	2	137	0	139
Vërtetim nga arkiva	0	48	0	48
Deklarate e bashekesise familjare	27	757	0	784
	162	6,463	0	6,625

shpresa.h.berisha

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e vdekjes	0	219	0	219
Certifikata e Shtetësisë	0	8	0	8
Ekstrakti i lindjes	0	1,717	8	1,725
Certifikata e Martesës	0	498	7	505
Certifikata e statusit martesor	0	96	1	97
Vërtetim nga arkiva	0	50	2	52
Certifikata e vendbanimit	0	179	0	179
Deklarate e bashkesise familjare	0	429	4	433
Certifikata e lindjes	0	1,238	7	1,245
	0	4,434	29	4,463

leotrim.e.berisha

Pershkrimi	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e vdekjes	0	94	0	94
Deklarate e bashkesise familjare	1	240	8	249
Certifikata e statusit martesor	0	30	2	32
Ekstrakti i lindjes	0	992	5	997
Certifikata e vendbanimit	0	121	0	121
Certifikata e Martesës	1	270	1	272
Hapat e mëtejme - Komuna e ka obligim që të merret me zbatimin e PZHk-së. Procesi i zbatimit do të monitorohet nga DUP-ja. Në përputhje me Ligjin e Planifikimit rreth zbatimit të tij nga ana e komunës përmes ekipit komunal për monitorim në çdo gjashte mujor DUP do të raportoj para autoritetit aprovues të tij.

Pritjet - Aprovimi i këtij plani ka hap rrugë për një zhvillim të qëndrueshëm sektorial ndër komunal për 8 vitet e ardhshme. Zbatimi i tij dhe hartimi i planeve tjera zhvillimore që rrjedhin pas PZHk-së gradualisht Komunën e vë në një sistem zhvillimor të planifikuar mirë.

5. Përmbyllje

Gjatë tremujorshit të dytë të vitit 2023 për DUP kanë qenë me angazhim të shtuar në zbatimin e vendimit të HZK-së, hartimin e raporteve, programeve, etj. Në përgjithësi puna vazhdon të kryhet mirë edhe përkundër numrit të kufizuar të stafit.

Vlen të ceket se:

- Në nivel të drejtorisë vazhdon të rritet transparenca e punës.
- Vazhdojnë të trajtohen me prioritet i lëndët varësisht nga kategoria e tyre.
- Numri i takimeve me qytetarë vazhdon të rritet çdo ditë.
- Është përmirësuar komunikimi me nivelin qendror në veçanti sa i përket MMPHI -së.
- Edhe përkundër mbingarkesës në punë vazhdon angazhimi i zyrtarëve në arritjen e objektivave të DUP.

Sfidë: *Sfidat pothuajse janë të njëjta me ato të specifikuara në raportin paraprake të DUP-së, ku vlen të cekën disa prej tyre:*

- Mungesa e zyrës së planifikimit dhe stafit të nevojshëm dhe profesional për të.
- Mos funksionimi i data bazës komunale ne softwerin qendror apo lokal për lexim të planeve dhe mos aktivizimi i licencave të GIS-it në disa kompjuter.
- Hapësirat e ngushta të punës dhe mungesa e një salle për shpalosje të planeve, për shqyrtime publike apo mbajtje të takimeve konsultuese me qytetar.
- Mos furnizimi me vite me letër, ngjyrë si dhe mos funksionalizimi i aparaturës për shtypje të hartave.

Drejtor i drejtorisë:
Visar KUÇI

Ky raport paraqet punën e Drejtorisë për Inspeksion në periudhën e gjashtë mujorit të parë të vitit 2023 (Janar – Qershor, 2023). Raporti paraqet aktivitetet dhe punën e Drejtorisë, sipas fushave të rregulluara me ligje, akte nënligjore, vendime dhe urdhëresa në fuqi.

Drejtoria për Inspeksion do të jetë përgjegjëse për këto detyra:

1. Që të zbatojë ligjet dhe aktet tjera nënligjore si dhe Rregulloret e Kuvendit Komunal të Suharekës;
2. Inspektorët, sipas përgjegjësisë dhe kompetencave, kanë për qëllim përcjelljen, monitorimin dhe marrjen e masave, përmes vendimeve dhe konkluzioneve administrative, në funksion të mbikëqyrjes inspektuese, të fushave të rregulluara me ligje, akte nënligjore, vendime dhe urdhëresa në fuqi;
3. Ushtron kontrollimin dhe inspektimin e objekteve industriale, tregtare dhe depove të mallrave-produkteve për treg;
4. Bën përcjelljen e çmimeve të artikujve dhe shikimin e faturave të tregtisë me shumicë dhe pakicë;
5. Hulumtojnë, konstatojnë, evidentojnë, udhëzojnë, evitojnë, ekzekutojnë dhe ushtrojnë fletëparaqitje në gjykatë;
6. Inspektorati kujdeset që të zbatohet plani urbanistik, gjegjësisht inspektimin e lejeve ndërtimore që lëshohen sipas dispozitave ligjore në fuqi;
7. Mbrojtja e konsumatorëve, gjegjësisht kujdesi për produktet ushqimore dhe joushqimore, të jenë në nivelin e duhur;
8. Mbrojtja e punëtorit në punë, mbrojtja dhe marrja e masave nga sëmundjet në: shëndetësi, bujqësi, ambient, komunikacion, shërbime publike, etj;
9. Koordinon aktivitetin dhe jep pëlqimin për veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave, me kompanitë publike dhe shoqatat e taksistëve individual dhe operatorëve juridik sipas rregulloreve;
10. Bën mbikëqyrjen e mbrojtjes së ambientit në aspektin e mbeturinave, kanalizimit, ujit, shërbimeve tjera publike, për parandalimin e ndotjes dhe dëmtimin e ambientit.
11. Bën mbikëqyrjen e aktiviteteve të cilat shkaktojnë çrregullime të përgjithshme në ambient, materiet e rrezikshme dhe zonat e mbrojtura në natyrë duke identifikuar palën përgjegjëse.

12. Cakton linjat dhe rendin e udhëtimit për transportin publik të udhëtarëve; 18.2.12 bashkëpunon me policinë për rregullimin e komunikacionit dhe ngritjen e sigurisë në komunikacion, në veçanti afër shkollave dhe institucioneve parashkollore;
13. Bën mbylljen e rrugëve për shfrytëzimin e tyre në raste të veçanta (festa shtetërore, punë të veçanta në interes të shtetit dhe komunës dhe punë të ngjashme);
14. Bënë kontrollin dhe inspektimin në lëmin e bujqësisë;
15. Kontrolli i hapësirave afariste, objekteve, pajisjet, prodhimin, qarkullimin dhe transportin e mallrave me origjinë bimore;
16. Merr masa për ruajtjen e shëndetit publikë dhe urdhëron tërheqjen e mallit të dyshimtë nga qarkullimi si dhe asgjësimin e tij;
17. Ushtron edhe kompetenca tjera që do t'i përcaktohen me ligj ose që delegohen nga pushteti qendror.

Në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit përveç Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit janë këto pozita:

Shefi i Inspeksionit

Inspektori i tregut

Inspektori i ndërtimit

Tre inspektorë të mjedisit dhe ambientit

Inspektori i komunikacionit

INSPEKTORËT E MJEDISIT

Gjatë këtij gjashtë mujori, është përcjellur gjendja e përgjithshme e mjedisit në çështjet komunale në tërë territorin e Komunës së Suharekës, sipas planit përkatës, konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi.

Inspektorët e ambientit I ka kryer detyrat e punës në kompetenc sipas Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit, Logji për parandalimin dhe luftimin e pandemic Covid-19 Ligji Nr. 07/L-006, Ligjet tjera të lëmisë përkatëse, Udhëzimeve administrative dhe Vendimeve Qeveritare.

Drejtoria për Inspeksion

Gjithashtu është bërë shqyrtimi i të gjithave ankesave të qytetarëve që i përkasin lamisë tonë dhe është vepruar sipas rregullorëve përkatëse.

Kanë bashkëpunuar me kolegët inspektor, te tregut, ndërtimtarisë, AUVK dhe Policinë e Kosovës.

Gjithashtu kanë bashkëpunuar edhe me qytetarët dhe bizneset për zbatimin e dispozitave Ligjore për të krijuar një ambient të pastër.

Kanë bërë kujdestari gjatë vikendeve dhe festive.

Është bërë aktivitet në bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante për pastrimin e hapësirave publike.

Pjesëmarrje në disa komisione të ndryshme, caktuar me aktvendime.

Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar këto procedura:

• Procesverbale	47
• Kontrollime inspektuese	109
• Urdhëresa për sanim të gjendjes	28
• Aktvendime	40
• Gjoha mandatore	10
• Procedura e sipër	18
• Vizita në teren me kërkesa të palëve	42
• Njoftime	2

Gjithashtu janë bërë edhe angazhime shtesë në asistimin e kolegëve në lëmi të ndryshme brenda Drejtorisë.

Drejtoria për Inspeksion

INSPEKTORI I TREGUT

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujori, inspektori i tregut ka kryer detyrat e punës të parapara me Ligjet e lëmisë përkatëse, Udhëzimeve administrative dhe Vendimeve. Ka bashkëpunuar me kolegë inspektor të Komunës sonë dhe kanë marrë pjesë në aksionet sipas kërkesës nga Ministria e Tregtisë, Industrisë, nga Ministrisë së Punëve të Mbrendëshme dhe ajo për Ekonomi dhe Financa, si për inspektimin e veprimtarive hoteliere, tregtare, furrave të bukës etj.

Inspektori ka bashkëpunuar me qytetarë dhe biznese për zbatimin e dispozitave Ligjore për të krijuar një treg konkurent dhe të besueshëm me qëllim të njoftimit të Ligjeve të reja (Vendimet) dhe duke ofruar këshilla të tjera.

Gjatë kësaj periudhe, janë kryer gjithsej:

• Procesverbale	210
• Në rregull	14
• Urdhëresa	19
• Inspektime	17
• Refuzime të pranimeve teknike	57
• Në procedurë	5
• Aktvendime	115
• Fletëparaqitje në Gjykatë	1
• Pranime të lokaleve	119
• Inkasimi i mjeteve nga Pranimi Teknik	6520 Euro.
• Asgjësimi i mallrave joushqimore	4

Drejtoria për Inspeksion

INSPEKTORI I NDËRTIMIT

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujori, inspektori i ndërtimit ka kryer detyrat e punës të parapara me Ligjet e lëmisë përkatëse, Udhëzimeve administrative dhe Vendimeve.

Gjatë kësaj periudhe, janë kryer gjithsej:

Nr.	Puna	Sasia	Kryer	Pa Kryer	Komente
1	Procesverbale	96			
2	Kontrolli i ndërtimeve pa leje ndërtimore	26			
3	Kontrolli i ndërtimeve me leje ndërtimore	32	19	13	
4	Konservimi i objekteve me shirit rrethues	8			
5	Aktvendime	12			
6	Nisje të procedurës për kundërvajtje në Gjykatë	6			
7	Rrënimi i objekteve pa leje	3			
8	Numri i bizneseve të inspektuara	18			
9	Të ndryshme	22			Punët e kryera nga lëmia e ambientit dhe ankesat e qytetarëve

Drejtoria për Inspeksion

INSPEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujori, inspektori i komunikacionit ka përcjell gjendjen e përgjithshme të komunikacionit rrugorë dhe çështjet tjera në tërë territorin e Komunës së Suharekës, sipas planit përkatës, conform ligjit dhe rregulloreve në fuqi.

Gjithashtu është bërë shqyrtimi I të gjitha ankesave të qytetarëve që I përkasin lëmisë së komunikacionit dhe është vepruar sipas rregullorëve përkatëse.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar këto procedura:

• Procesverbale	38
• Kontrollime inspektuese	62
• Aktvendime	63
• Gjoha mandatore	5
• Vizita në teren me kërkesa të palëve	47
• Rende të Udhetimit	24

PLANIFIKIMI I OBJEKTIVAVE TE DKA-së PËR PERIUDHEN JANAR-QERSHOR 2023

Drejtoria e Arsimit gjatë kësaj periudhe në të gjitha institucionet edukativo arsimore është fokusuar në realizimin e objektivave të përcaktuara për vitin 2023 në planin vjetor të punës të cilat janë hartuar në mbështetje të objektivave kombëtare dhe strategjike të MASHTI si dhe objektivave komunale në PZHK të DKA-së të miratuar nga Asambleja Komunale e të cilat janë shndërruara në detyra konkrete siç janë:

- Ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie në shkollat tona.
- Ngritjen e suksesit të nxënësve dhe rritjen e nivelit të vijueshmërisë së nxënësve në procesin edukativo-arsimor.
- Realizimin e plan-programeve mësimore sipas fushave të KKK
- Gjithëpërfshirja në arsim dhe krijimi i kushteve të volitshme në institucionet tona edukativo-arsimore.
- Zbatimi i ligjit të arsimit parauniversitar dhe Udhëzimeve Administrative qe e rregullojnë fushën e arsimit.
- Pajisja e shkollave me kabinete, laboratorë, biblioteka dhe mjete tjera për konkretizimin e mësimin.
- Monitorimin e punës në të gjitha institucionet shkollore.
- Vlerësimin e performancës së drejtorëve /zv.drejtorëve të shkollave .
- Menaxhimi i sigurisë në të gjitha nivelet e arsimit dhe në të gjitha institucionet edukativo- arsimore.
- Sigurimi i mjeteve mbrojtëse-higjenike për kujdesin dhe ruajtjen e shëndetit të nxënësve në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të komunës sonë
- Rregullimin, pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambientit të brendshme dhe të jashtëm të shkollave
- Bashkëpunimin me donatorë të jashtëm e të brendshëm për investime në shkolla Funksionimi i 29 SHFMU me 11 paralele të ndara , 3 SHML si dhe institucioni parashkollor –

çerdhja e fëmijëve “Flutura” me paralele të ndara në Duhël, Mushtisht, Sopijë, Gjinoc, Studenqan dhe Samdraxhë krijon kushte optimale për mbarëvajtjen e procesit edukativo- arsimor. Me

Drejtoria për Arsim

ndërtimin e objekteve të reja dhe rregullimin e infrastrukturës janë krijuar mundësitë e organizimit të mësimi në një ndërrim në :

- 22 SHFMU shkolla amë,
- 7 paralele të ndara fizike dhe
- SHML “A. Ramaj” në Shirokë.

Gjatë periudhës vijuese DKA në Suharekë ka planifikuar për krijimin e kushteve edhe në shkollat tjera për organizimin e mësimi në një ndërrim.

Numri i nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit në komunën tonë

Planifikimi i numrit të paraleleve dhe numrit të nxënësve për vitin shkollor 2022/2023 është bërë në mbështetje të UA nr. 16/2004 të MASHT dhe në bashkëpunim me shkollat fillore janë regjistruar nxënësit në klasat e para . Gjithashtu planifikimi dhe regjistrimi i nxënësve në shkollat e mesme të larta është realizuar në bashkëpunim me MASHTI dhe SHML.

Në këtë vit shkollor numri i fëmijëve/nxënësve është 9201 (duke përfshirë edhe çerdhen “Flutura” në Suharekë). Në krahasim me vitin shkollor 2021/22 numri i nxënësve është zvogëluar për 481 nxënës. Vlen të theksohet se zvogëlim të numrit të nxënësve ka në të gjitha shkollat rurale kurse rritje në ato urbane.

Suksesi dhe vijimi i nxënësve në gjysëmvjetorin e parë të vitit shkollor 2022/2023

Në vazhdim e paraqesim suksesin e nxënësve në gjysëmvjetorin e parë të vitit shkollor 2022/2023

Nr	Niveli Arsimor	Shkëlq.	Sh.mire	Mirë	Mjaf.	Me një e më shumë nota të dobëta	Të pa notuar	Gjithsej
1	Arsimi Fillor	2669	1330	1260	391	739	122	6511

2	Arsimi i mesëm	270	450	395	51	641	8	1815
Gjithsej		2939	1780	1655	442	1380	130	8326

☐ Suksesi i paraqitur në formë skematike



- ☐ Sukses pozitiv janë 83% e nxënësve kurse 17% negativ,
- ☐ Nota mesatare në të tri nivelet e arsimit është 3.58;
- ☐ Duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi rritje të suksesit (kalueshmërisë) nga 76% në 83%.

Drejtoria për Arsim

Kuadri : Në arsimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë janë të angazhuar 990 punëtorë, shih tab.

Nr	Programi arsimor	Personeli			Gjithsej personeli 2022/2023
		Mësimdhënës	Personeli administrativ	Personeli mirembajtes	
1	Çerdhja "Flutura" Suhareke	20	2	8	30
2	Shkolla fillore, e mesme e ulët	633	48	94	775
3	Shkolla e mesme e lartë	179	10	24	213
	Gjithsej	832	60	126	1018

Planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasë të para (I) në shkolla fillore dhe klasë të dhjeta (X) të shkollave të mesme të larta për vitin shkollor 2023/24

Për vitin shkollor 2023/24 në mbështetje të UA nr. 09/2023 të MASHT dhe në bashkëpunim me shkollat fillore është planifikuar numri i paraleleve dhe numri i nxënësve në klasë të parë i cili është zbatuar nga të gjitha shkollat fillore .

Shkollat e mesme të larta planifikimin e klasave të dhjeta (X) e kanë mbështet në nevoja e tregut të punës ne nivel komunal dhe ne nivel vendi sipas të dhënave të poshtëshenuara :

Drejtoria për Arsim

Gjimnazi "JETA E RE" SUHAREKË
Shkenca Natyrore
Shkenca Shoqërore

IAAP "A. RAMAJ " SHIROKË
Ekonomi, administim dhe juridik
Shërbime
Makineri, prodhim dhe ndërtimtari
Agrokulturë, pylltari, peshkatarë dhe veterinarë
Shëndeti dhe mirëqenia

IAAP "S. LUARASI" SUHAREKË
Elektroteknikë
Makineri
Tekstil
Ndërtimtari
Arti

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë periudhës : Janar – Qershor 2023

Fillimi i vitit shkollor 2022/2023 ishte sfidues për të gjitha institucionet edukativo-arsimore me organizimin e grevës nga SBASHK-u e cila krijoi humbje të mëdha të orëve mësimore, dëshpërim të prindërit dhe të nxënësit por edhe sfidë për mësimdhënësit. MASHTI hartoi planifikimin e kompensimit të orëve mësimore mirëpo nuk është realizuar nga mësimdhënësit. Prandaj edhe në tremujorin e parë të vitit 2023 shqetësues ishte fakti i kompensimit të orëve të humbura gjatë grevës në muajin shtator.

Ndërsa nga raportet e shkollave dhe konsultat me drejtorë të shkollave si dhe analizës së situatës mund të konstatojmë se mbarëvajtja e mësimit të rregullt gjatë kësaj periudhe është realizuar me sukses

Vlerësimi i jashtëm i njohurive të nxënësve

(Testi i arritshmërisë-kl. 9, Testi i maturës-12, Testi ICILS –kl 8 dhe Testi TIMSS-kl.4)

Ne bashkëpunim me MASHTI ,DKA i ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të njohurive të nxënësve : testit TIMSS për kl të IV-ta, testit të arritshmërisë për kl.9 si dhe provimit të maturës shtetërore për afatin e qershorit -kl 12 dhe Testi ICILS–kl 8.

Drejtoria për Arsim

Testi ICILS 2023 – Ky vlerësim ndërkombëtar është planifikuar dhe realizuar nga MASHTI në bashkëpunim me DKA –të. Në këtë vlerësim pjesëmarrës ishin nxënësit e kl. 8(tetë) të shkollave të mesme të ulëta :

- SHFMU “ B. Curri” Nishor,
- SHFMU “B. Ndrecaj” në Maqitevë,
- SHFMU “D. Bajraktari” Suharekë,
- SHFMU “Dituria” Samadraxhë dhe
- SHFMU “ Migjeni” Gjinoc.

Testi ka të bëjë me vlerësimin e njohurive të nxënësve nga fusha e TIK-ut.

Testi TIMSS 2023- Këtij vlerësimi ndërkombëtar të organizuar nga MASHTI dhe DKA iu nënshtruan nxënësit e kl.4 (katërta) të :

- SHF “ 7 Marsi “ Suharekë,
- SHF” Shkendija” Suharekë,
- SHF “ E. Durham” Mushtisht,
- SHF “D. e Tivarit” Peqan,
- SHF” V. P. Shkodrani” Leshan dhe
- SHF’ Dituria” Samadraxhë .

DKA i ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e këtij testi dhe presim rezultate të mira .

Matura 2023 -Sipas vendimit të MASHTI- Provimi i maturës 2023 është planifikuar të organizohet në dy afate :

- Afati i parë me datë 24 qershor 2023 dhe
- Afati i dytë me datë 26 gusht 2023

Drejtoria për Arsim

Shkollat dhe DKA janë angazhuar për të bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e testit të maturës duke siguruar hapësirë së përshtatshme, ujit të pijes dhe lapsa (në rast se u mungojnë nxënësve) .

Bazuar në të dhënat e shkollave 534 maturantë të rregullt :

- Gjimnazi “ Jeta e Re”- 247 nxënës,
- IAAP “Skënder Luarasi” Suharekë-182 nxënës
- IAAP “ Abdyl Ramaj “ Shirokë -105 nxënës

Testi i arritshmërisë-kl. 9 -Bazuar në vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Komuna e Suharekës do të organizoi Testin e Arritshmërisë për klasat e IX-ta me datë :

-Pjesa e parë në lëndët gjuhë amtare,gjuhë angleze, histori dhe gjeografi organizohet me 04.07.2023

-Pjesa e dytë në lëndët matematikë,informatikë,fizikë,kimi dhe biologji organizohet më 11.07.2023

Këtij vlerësimi do t’i nënshtrohen të gjithë nxënësit e klasave të nënta (IX) gjegjësisht 715 nxënës.

DKA dhe shkollat i kanë bërë të gjitha përgatitjet për organizimin dhe mbarëvajtjen e testit të arritshmërisë të klasave të IX-ta.

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore përveç SBASHK-ut nuk janë organizuar aktivitete- trajnime për zhvillim profesional të mësimdhënësve nga MASHT-i dhe DKA .Mund te theksojmë se për këto programe të trajnimeve te organizuara nga SBASHK-u , DKA nuk ka informata .

Vizitat e realizuara në shkolla

DKA me qëllim të avancimit të punës në institucionet shkollore ka planifikuar vizitat e rregullta në shkolla për kontrollimin e mbarëvajtjes se procesit edukativo-arsimor,mirëmbajtja e dokumentacionit pedagogjik-administrativ mirëmbajtja e ambientit të brendshëm dhe të jashtëm të shkollës:

1. Kontrollimi dhe marrja e informatave për dokumentacionin pedagogjik
2. Dokumentacioni administrativ: Libri i të punësuarve, Libri i protokollit, Libri i klasave, Procesverbalet, Librat amë etj..
3. Vlerësimi i përformancës së shkollës dhe PZSHSH
4. Plani dhe programi vjetor i punës në shkollë: Planet e drejtorit, planet e aktiveve profesionale, këshillit të mësimdhënësve, këshillit të klasave, planet e aktiviteteve jashtëmësimore etj.
5. Orët e humbura
6. Mjetet mësimore
7. Organizimi i mësimit të rregullt dhe mësimit plotësues.

Për të gjitha shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të vizituara janë hartuar procesverbalet e incizimit të gjendjes së bashku me rekomandimet për të eliminuara lëshimet e konstatuara.

Vlerësimi i përformancës së drejtorëve /zëvendës drejtorëve te shkollave

Në bazë të UA-106/2020,DKA ka formuar komisionin për vlerësim të përformancës së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave për periudhën e punës katërvjeçare. Komisioni prioritet për vlerësim të përformancës kishte drejtorët dhe zëvendës drejtorët të cilëve iu përfundonte mandati (kontrata e punës) –drejtor/zv.drejtor shkolle. Procesi i vlerësimit të brendshëm është realizuar për 7 drejtor /zv.drejtor të shkollave dhe jemi në proces të vlerësimit për shkollat tjera.

Procesi i vlerësimit ka përfunduar për pesë (5) drejtor të shkollave

1. Elmi Aliu- drejtor në SHFMU” Besim Ndrecaj” në Maqitevë./ rivleresim
2. Xhavit Shala- drejtor në SHFMU” 28 Nëntori” në Dobërdelan/rivleresim
3. SHFMU ” Xhavit Sylaj” në Sllapuzhan
4. Fehim Behluli në SHFMU” Edit Durham” në Mushtisht
5. SHFMU”Lidhja e Prizrenit” në Budakovë.

Në proces të rivlerësimit janë dy drejtor të shkollave:

1. Fidaim Grulaj në SHFMU" Dëshmorët e Tivarit" në Peqan/Kontrata e punës i skadon më:10.01.2024.
2. Bajram Rraqi në SHFMU" Dëshmorët e Kombit" në Vraniq/ Kontrata e punës i skadon më:10.01.2024.

Në proces të vlerësimit të jashtëm të performances janë:

1. Zv.drejtorin e SHFMU"Sadri Duhla" në Duhël në komunën e Suharekës.
2. SHFMU:" 17 Shkurti" në Shirokë.
3. SHML Gjimnazi" Jeta e Re" zv.drejtor në Suharekë.
4. SHMT:Skënder Luarasi" në Suharekë.
5. SHFMU"7 Marsi" në Suharekë.
6. SHFMU"V.P.Shkodrani" në Suharekë.

Në proces të vlerësimit të brendshëm të performancës

SHFMU"Iliria" Savrovë	Xhemajl Zenelaj	08.07.2019	07.07.2023
SHFMU"Dituria"	Xhafer Zeqaj	08.07.2019	07.07.2023
SHFMU"Sadri Duhla"Duhël	Hamdi Rrafshi	22.07.2019	21.07.2023
Gjimnazi"Jeta e Re" në Suharekë	Fadil Elshani	09.09.2019	08.09.2023
SHFMU"Shkëndija"Suharekë	Ilmi Shala	10.10.2019	10.10.2023
IAAP"A. Ramaj" Shirokë	Agron Suka	11.10.2019	11.10.2023
IP"Fluturat"	Arlinda Bajraktari	02.11.2019	02.11.2023

Drejtoria për Arsim

Garat, aktivitetet e lira dhe aktivitetet jashtëmësimore

DKA ka përgatit rekomandimet për shkolla për realizimin e aktiviteteve në nivel të shkollave për ngritjen e cilësisë dhe motivimin e nxënësve për punë. Fokusi ka qenë që të gjitha aktivitetet të barten në shkolla në mënyrë që të përfshihen dhe motivohen të gjithë nxënësit pa përjashtim.

Në kuadër të bashkëpunimit me OJQ –të për realizimin e projekteve të miratuara nga MASHT-i, DKA ka organizuar garat në nivel të shkollave dhe garat në nivel komunal në lëndën e fizikës dhe lëndën e matematikës ,nxënësit të cilët kanë treguar sukses më të mirë kanë marr pjesë në gara republikane.

- Organizimi i manifestimit me rastin e Ditës së mësuesit – 7 Marsin, me këtë rast Drejtoria e Arsimit ka ndarë mirënjohje dhe shpërblime për drejtorin dhe mësime të dalluar për vitin 2023 për të tri nivelet e arsimit duke përfshirë edhe çerdhen “Flutura” në Suharekë.

Siguria në shkolla

Drejtoria e Arsimit duke pasur parasysh që nxënësit një pjesë shumë të madhe të kohës e kalojnë në ambientet shkollore dhe është shumë më rëndësi që jo vetëm për mirëqenien e tyre po edhe për vetë procesin edukativo-arsimor, të ketë siguri të lartë në shkollë është sensibilizuar për të krijuar kushte sa më të volitshme. Natyrisht, se janë një sërë faktorësh të cilët ndikojnë në krijimin e bindjeve dhe perceptimeve për sigurinë në shkollë, prandaj DKA ka marr të gjitha masat për krijimin e një klime sa më të mirë në të gjitha institucionet edukativo- arsimore.

Drejtoria për Arsim

Buxheti i planifikuar i shpenzimeve gjatë periudhës Janar-Qershor 2023

Buxhet për arsimin në nivel komune ndahet në bazë të disa kritereve të përcaktuara me Ligjin e Arsimit Parauniversitar dhe Udhëzimit Administrativ në fuqi .Kriter bazë është numri i nxënësve,prandaj DKA – ka një buxhet dhe numër të punëtorëve më të lartë në Komunë .Duke marrë parasysh këto kritere (numrin e nxënësve,numrin e punëtorëve si dhe numrin e objekteve shkollore) është planifikuar edhe bugjeti për vitin 2023 -

Buxhet i DKA-së dhe shkollave brenda këtij raporti 6 mujor nga të gjitha fondet burimore i nxjerr nga SIMFK është në këtë përmbajtje:

Drejtoria për Arsim

DKA

Objekti	Buxheti Vjetor	Buxheti aktual 6 mujor	Shuma e shpenzuar	% e shpenzimit 6 mujor
Paga dhe mëditje	72,000	36,000	36,252	100.70%
Mallra dhe shërbime	185,000	92,500	72,940	78.85%
Subvencione	100,000	50,000	97,000	194%
Pasurit Jo Financiare	445,000	222,500	0	0%
Mallra dhe shërbime THV FB- 21	155,000	77,500	6,588	8.50%
Subvencionet THV FB21	70,000	35,000	42,650	121.86%
Komunalit THV FB21	42,000	21,000	0	0%
Gjithsej		534,500	255,430	47.79%
Arsimi Parafillor-çerdhja				
Objekti	Buxheti aktual 6M	Buxheti aktual 6M	Aktuali I shpenzuar	% e shp.te buxhetit
Paga dhe mëditje	181431	90,716	77,359	85.28%
Mallra dhe shërbime	34000	17,000	9,383	55.19%
Komunali	6000	3,000	2,968	98.93%
Mallra dhe shërbime TVH FB10	6000	3,000	0	0
Gjithsej		113,716	89,710	78.89%
Arsimi Fillor				

Drejtoria për Arsim

Objekti	Buxheti Vjetor	Buxheti aktual 6M	Aktuali I shpenzuar	% e shp.te buxhetit
Paga dhe mëditje	4,672,961	2,336,481	2,286,789	97.87%
Mallra dhe shërbime	508,472	254,236	127,754	50.25%
Komunali	59,000	29,500	19,467	65.99%
Pasurit jo financiare	120,000	60,000	0	0%
Shpenzimet Komunale THV FB21	30000	15,000	0	0
Mallra dhe Shërbime FB31	1656	828	0	0
Gjithsej A.Fillor		2,696,045	2,434,010	90.28%
Arsimi I Mesëm				
Objekti	Buxheti Vjetor	SBuxheti actual 6m	Aktuali I shpenzuar	Bilanci
Paga dhe mëditje	1400100	700,050	854,415	122.05%
Mallra dhe shërbime	148131	74,065	60,780	82.06%
Komunalit	30000	15,000	7,425	50.00%
Komunalit THV FB21	20000	10,000	0	0%
Gjithsej A.i Mesem	1598231	799,116	922,620	115.46%

- ☐ Sipas këtyre informatave konstatojmë se kategoria e Pagave dhe Mëditjeve për DKA- në dhe Arsimin e mesëm, ka tejkalime të buxhetit, kjo ndodhi për arsye të aplikimit të Ligjit të ri të pagave.

Drejtoria për Arsim

Shuma e projekteve	565,000.00											
--------------------	------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Bursat e nxënësve dhe studenteve

Drejtoria e Arsimit me autorizim të Kryetarit të Komunës gjatë muajit shkurt publikoi konkursin për bursa për vitin shkollor 2022/2023 për gjithsej 350 bursa, prej tyre 200 bursa për student dhe 150 bursa për nxënës. Në këtë konkurs kanë aplikuar 546 nxënës dhe student. Komisioni për ndarjen e bursave ka zbatuar Rregulloren për ndarjen e bursave të vitit 2019 të miratuar nga Asambleja Komunal dhe plotësim- ndryshimin në vitin 2021.

Konkurset

Në mbështetje të UA nr.15/2019 dhe UA nr.05/2021 dhe UA nr.05/2015– Normativeve të MASHT për pranimin e kuadrit arsimor, janë shpallur:

☐ Tre (3) konkurse për drejtor shkolle :

-SHFMU"Ramë Bllaca"në Bllacë (rishpallje) për të cilin është përfunduar procedura me sukses .

-SHFMU" Bajram Curri"në Nishor (në procedurë të konkurrimit)

-SHFMU " Flamuri i Arbrit" në Reshtan (në procedurë të konkurrimit)

☐ Dy (2) konkurse për mësimdhënës, edukatore dhe staf mbështetës ku janë publikuar gjithsej trembëdhjetë (13) pozita prej tyre: gjashtë pozita për mësimdhënës, tre pozita për edukatore dhe dy pozita për punëtor teknik të cilat kanë përfunduar të gjitha procedurat..

☐ Tre (3) konkurse për psikolog :

- Një psikolog në IP"Fluturat"-Suharekë(rishpallje)

- Një psikolog në SHFMU"Sadri Duhla " në Duhël

- Një psikolog në SHFMU"7 Marsi"në Suharekë është në procedurë të konkurrimit.

Pensionime:Gjatë kësaj periudhe janë pensionuar gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) punëtor

Drejtoria për Arsim

Pushime të lehonisë :

Gjatë periudhës gjashtëmujore në pushim të lehonisë kanë shkuar nëntëmbëdhjetë (19) punëtorë

Për të gjitha pozitat është zhvilluar procedure konform UA në fuqi.

Takime të rëndësishme të DKA-së

-Takimet e rregullta javore konsultative të drejtorëve komunal me Kryetarin e Komunës.

- Takime pune me inspektorët e arsimit të SIA-së në Prizren
- Takimet zyrtare në MASHT
- Takime me SIA
- Takimet në asamblenë komunale
- Takimet javore me stafin e DKA-së
- Takimet mujore me drejtorët e shkollave.
- Takime të ndryshme me organizata dhe donatorë për realizimin e projekteve për ngritjen e cilësisë në arsim.

Objektivat për periudhën e ardhshëm

- Ngritja e suksesit të nxënësve për periudhën e ardhshme dhe zvogëlimi i numrit të mungesave
- Shpallja e konkursit dhe pranimi i kuadrit në bazë të normativit për pranim të kuadrit.
- Organizimi dhe mbajtja e vlerësimeve brendshme dhe te jashtme te njohurive të nxënësve
 - Planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve jashtë mësimore në kuadër të shkollave.
 - Pajisja e shkollave me mjete mësimor.
 - Rregullimi dhe meremetimi i objekteve shkollore me prioritet.
 - Vizitë- monitorim dhe kontroll sipas planifikimit dhe nevoja të shkollave.

- Në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale funksionojnë 2, (dy) sektorë si vijon;

- Sektori i Shëndetësisë
- Sektori i Punës dhe Mirëqenies Sociale

- **Departamenti i Administratës së DSHMS-së**

- Drejtori i DSHMS-së
- Zyra e Udhëheqësit
- Zyra Ligjore
- Zyra për buxhet dhe financa
- Zyra për qeshtje Administrative

- **Aktivite kryesore në DSHMS**

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqeni Sociale, do të jetë përgjegjëse për këto detyra;

- hartimin e strategjisë për kujdesin parësor shëndetësor që përfshinë: promovimin, parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, edukimin shëndetësor, imunizimin;
- monitorimi i gjendjes shëndetësore të popullatës për ti identifikuar, analizuar shkaqet dhe zgjidhur në kohë problemet dhe rreziqet për shëndetin e popullatës;
- zhvillimin e politikave dhe planeve që mbështesin përpjekjet shëndetësore të individit dhe komunitet në përgjithësi;
- informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës rreth çështjeve shëndetësore dhe shëndetit publik;
- kryerjen e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës, përmes aktiviteteve të qendrës për punë sociale ose duke siguruar financim apo ndonjë ndihmë tjetër materiale për organizatat joqeveritare që merren me këtë veprimtari;
- të zhvillojë buxhetin bazuar në nevojat lokale duke iu përmbytur udhëzimeve nga MSH;
- siguron ofrimin e shërbimeve shëndetësore;
- raporton mbi të arriturat e objektivave të përcaktuara për Kryetarin e Komunës dhe Kuvendit të Komunës;
- zhvillimi, monitorimi dhe zbatimi i rregulloreve ekzistuese që i lëshon MSH dhe Kuvendi i Komunës;
- e drejta për të pasur, zhvilluar dhe për të përdorur pronën me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda komunës;
- monitorimi dhe bashkëpunimi me QPS në Komunë rreth përkujdesjes së rasteve sociale të popullatës së Komunës;
- bashkëpunon me MSH, vendos dhe zbaton politikat e mbrojtjes së kategorive të fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha kategoritë tjera të fëmijëve, përmes QPS, në nivelin lokal;
- mbikëqyrjes së situatës epidemiologjike në nivel të komunës;
- koordinimi dhe mbikëqyrja e punës së QKMF, QMF dhe ambulancave dhe Qendrës për Punë Sociale;
- vendos dhe mbledh bashkë-pagesat, propozon që t'i vendosë lirimet për shërbime ndaj qytetarëve nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin aplikativ;

- marrja e hapave për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare, brenda territorit të Komunës;
- përkujdeset për sigurimin e strehimit për të pastrehët;
- bënë kontrollimin dhe inspektimin në lëmin e sanitarisë në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi;
- do t'i ushtroj edhe kompetencat tjera që dalin nga ligjet e veçanta, statut të komunës, akte nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësit në Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë periudhës 01.01.2023 deri me 30.06.2023, janë kryer këto shërbime:

Nr.	Emertimi i punëve të kryera	Gjithësejë
1.	Shkresa të ndryshme si: njoftime, kërkesa, përgjigje, etj.	205
2.	Referenca pune	4
3.	Formular për botën e jashtme.	795
4.	Kërkesa për ndihmë momentale të miratuara.	195
5.	Formular për vazhdim të pensioneve	18
6.	Kërkesa për subvencione të lindjes	6
7.	Raport financiar për tri programet buxhetore	5
8.	Raport për faturat e pa paguara për tri programe tbuxhetore	5
9.	Shpallja e 44 vendeve te lira pune (shpallje e konkurseve)	11
10.	Angazhim rreth konkurseve interne të QKMF-së	8
11.	Përgaditja e lëndës për shpalljen e tenderit per DDD.	1
12.	Përgaditja e lëndës për shpalljen e tenderit per projektin per skamnorët	1
13.	Vendime , Aktvendime	21
14.	Përgaditja e lëndëve për pagesë në DSHMS	246
15.	Kërkesa për shërim banjo-klimatik të miratuara	57

16.	Kërkesë për alokim të mjeteve	5
-----	-------------------------------	---

Po ashtu me datë 06.03.2023 DSHMS së bashku me Kryetarin e Komunës, Kompanin Solid SH.P.K dhe Laboratorin Pathology kemi nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me nr protokoli 01-016-15551 datë 06.03.2023 për subvencionimin e 500 grave për analizën PAP TEST, DSHMS menjëher ka filluar implementimin e kësaj marrëveshje. Vlenë të theksohet se ka një interesim mjaft të madhë për kryerjen e analizës PAP TEST.

Gjithëashtu me datë 24.03.2023 kemi vizituar QMF- Bukosh, QMF-Mushtisht dhe AMF- Sopijë ku kemi biseduar me personelin e këtyre qendrave për punën dhe sfidat me të cilat ballafaqohen.



DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Me datë 27.03.2023 së bashku me QPS-Suharekë kemi bërë implementimin e Marrëveshje Bashkëpunimi me nr protokoli 01-104-19307 datë 21.03.2023 mes Komunës së Suharekës dhe Organizatës Qatar Charly, objekt i së cilës ishte shpërndarja e 250 pakove ushqimore për familjet skamnore të cilat janë shfrytëzuese të ndihmave sociale pranë Qendrës për Punë Sociale.



Me datë 07.04.2023 është lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi me numër protokoli 01-016-24808c ndërmjet Banjës së Kllokotit dhe Komunës së Suharekës, qellimi i së cilës është shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore – fizioterapeutike. Deri më tani në baze të kësaj marrëveshje janë miratuar 57 kërkesa prej të cilave 7 kërkesa janë të miratuara me përcjellës.

Realizimi i buxhetit për programet e shëndetësisë sipas planit të keshit:

DSHMS- 90.44%

QKMF- 68.94%

QPS – 74.45%

Realizimi i buxhetit nga mjetet vetanake (21):

DSHMS – 84.82%

QKMF – 33.51%

QPS – 0.00%

Në total realizimi i buxhetit për tri programet e shëndetësisë për të gjitha kategoritë ekonomike është 66.07%.

Duke u bazuar në rreguloren për ndarjen dhe subvencioneve është bërë subvencionimi i 195 personave me kushte jo të mira ekonomike dhe me sëmundje të ndryshme, në vlerë prej 43.440.00 (dyzet e tre mijë e katër qind e katërdhjetë euro) prej të cilave 2000.00 (dy mijë euro) janë subvencione të lindjes.

Po ashtu konform Vendimit të Asamblesë është bërë pagesa në vlerë prej 3024,00 (tre mijë e njëzet e katër euro) për familjet përfituese të Bonus Banimit.

Është bërë edhe nënshkrimi i marrëveshjes për libreza sanitare sipas ligjit detyrave dhe përgjegjësi.

Bazuar në konkurset e shpallura nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është bërë rekrutimi i stafit shëndetësor prej 38 pozitive sipas konkurseve me nr te protokollit, si në vijim:

- Vendimi me nr prot. 06-923 date 19.05.2023 - 11 Mjek të Përgjithshëm -
- Vendimi me nr prot. 06-996 date 30.05.2023 - 15 Infermier të përgjithshëm
- Vendimi me nr prot. 06-961 date 26.05.2023 - 5 Infermier në Urgjencë
- Vendimi me nr prot. 06-985 date 30.05.2023 - 3 Teknik Medicinal në Stomatologji
- Vendimi me nr prot. 06-962 date 26.05.2023 - 2 Mami Medicinale në Gjinekologji
- Vendimi me nr prot. 06-991 date 30.05.2023 - 1 Teknik i RTG
- Vendimi me nr prot. 06-990 date 30.05.2023 - 1 Teknik i Farmacisë



Gjithashtu me datë 21.06.2023 është bërë vizita në raportin e gjinekologjisë në QKMF “REXHEP KUQI” në Suharekë, u njoftuam me angazhimin e stafit për projektin Screening-ut të qafës së mitrës dhe bazuar në marrëveshjen në mes të donatorëve “Solid SHPK” dhe laboratorit “Pathology”, deri më tani janë realizuar mostra si në vijim:

216 mostra PAP-Test

117 janë mostra negative

55 mostra përsëritje e testit pas 3 muajve

11 mostra janë rekomanduar për biopsi

27 mostra janë në pritje për rezultate



Po ashtu me datë 15.06.2023 është mbajtur takimi me përfaqësuesit e Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) ku është diskutuar mbi fillimin e një programi të ri, për avansimin e barazisë gjinore dhe integrimin e qasjes gjithëpërfshirëse në proceset politikbërëse dhe në vendimmarrje. Qëllimi i këtij takimi ishte inicimi dhe impementimi afatgjate sa i përket barazisë gjinore mbi mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen.



Po ashtu, ne kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë veprojnë ekipet mobile për trajtimin e problemeve sociale – shëndetësore të cilat ekipe gjatë kësaj periudhe kanë bërë rreth 198 vizita në teren për njerëzit në nevojë.



DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Gjatë kësaj periudhe është bërë implementimi i marrëveshjes me nr protokoli 01-016-74473 e lidhur me datë 24.11.2022 në mës të Komunës së Suharekës dhe Qendrës për Srehimin e Grave dhe Fëmijëve. Me datë 21.06.2023, është caktuar mbikqyrësi i kësaj marrëveshje i cili ka për detyrë që të shërbejë si pikë kontakti mes palëve.

Drejoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë kësaj periudhe vazhdimisht është angazhuar në bazë të planit të Prokurimit për vitin 2023 për ndërtimin e dy Qendrave të Mjekësisë Familjare në fshatin Duhël dhe në fshatin Studenqan. Së pari është bërë kërkesa në Drejtorinë për Urbanizëm për kushtet ndërtimore, dhe pas aprovimit t kushteve ndërtimore ka pergaditur dokumentacionin e nevojshëm për leje ndërtimore për këto dy QMF.

Gjithashtu gjatë këtij 6 mujori në Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale janë kryer edhe punë tjera si takime me qytetar dhe diskutimi me ta lidhur me problemet e tyre si dhe punë tjera sipas nevojës së DSHMS-së, lëshimi i dëftesave për pagesa të parapara në DSHMS.

Aktivitete kryesore në QKMF

Departamenti i Mjekësisë Familjare

Spektori i Mjekësisë Familjare

Njësia e SISH

Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit

Spektori i Shëndetit Oral Preventiv

Spektori i Kujdesit Urgjent

Spektori konsultativë dhe Diagnostikë

Shërbimet konsultative

Kabineti Radiologjik

Laboratori

Departamenti i Administratës së QKMF-së

Zyra e personelit

Zyra Juridike

Zyra për buxhet dhe financa

Zyra për shërbime teknike

Barnatorja Qendrore

Shërbimi publik shëndetësor në Komunën e Suharekës është i organizuar në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe ka një shtrirje të gjerë dhe mbulon tërë territorin e Komunës.

QKMF-Suharekë është Institucion publik i kujdesit parësor shëndetësor i cili qëllim kryesor ka promovimin, ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të komunitetit.

Shërbimet shëndetësore janë të ofruara në konceptin e Mjekësisë Familjare, ku gjithëpërfshirja, barazia, cilësia, ndershmëria dhe përgjegjësia, kosto-efektiviteti janë parimet bazë të ofrimit të këtyre shërbimeve.

Shërbimet të cilat ofrohen në QKMF janë: shërbimi i mjekësisë familjare, shërbimi i urgjencës mjekësore (24 orë), shërbimi i shëndetit oral, shërbimi i imunizimit dhe vaksinimit, shërbimi i diagnostikës, shërbimi i këshillëdhënies për nëna dhe gjinekologjisë, barnatorja qendrore dhe shërbimi i transportit të pacientëve.

QKMF aktivitetin e vet e realizon përmes rrjetit të njëjësive organizative, që përfshin Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), gjashtë Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në Mushtisht, Studenqan, Duhël, Gjinoc, Mohlan dhe Bukosh dhe njëmbëdhjetë Ambulata të Mjekësisë Familjare (AMF) në Grejkoc, Samadrexhë, Sopi, Nishor, Dobërdelan, Leshan, Semetisht, Sallagrazhde, Reqan, Budakovë dhe Bllacë.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në QKMF është 145 persona, prej tyre 16 Specialist të Mjekësisë Familjare, 1 Pediatër, 1 Radiolog, 11 Mjekarë të Përgjithshëm, 9 Stomatolog dhe tjeret infermier dhe stafe ndihmes.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Rexhep Kuqi" në kuadër të punëve dhe detyrave konform Ligjit dhe Statutit të QKMF-së, ka kryer shërbime të ndryshme të cilat janë të parapara.

Si çdo fillim të muajit njoftohen të gjithë qytetarët të cilët janë Insulinëvartës se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare është furnizuar me Insulina dhe të njëjtit mundë të furnizohen me to, pra edhe në muajin shkurt kemi bërë njoftimin me kohë për të gjithë qytetarët.



Ashtu edhe siç ka qenë e planifikuar me planin e punës të QKMF-së, në shkurt është implemetuar dhe funksionalizuar projekti i SISH-it, ku e gjithë Mjekësia Familjare, Vaksinimi, Urgjenca janë duke e implemetuar këtë program, gjithashtu të gjitha QMF-t janë paisur me paisje për të funksionuar programin e SISH-it, ku deri në Marsë synojm të implemetohet në të gjitha qendrat e QMF-ve.

Në kuadër të Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional, me datë 07, Shkurt, 2023 në QKMF "Rexhep Kuçi", është mbajtur ligjerata me temën "ROLI I INFERMIERIT NË VIZITAT SHTËPIAKE", ku morrën pjesë infermierë, mami dhe profesionistë të tjerë shëndetësor.

Ligjeratat janë mbajtur nga trajneret: Nazmije GASHI dhe Arbërije KOLGECI.



Në muajin shkurt përveq detyrave dhe shërbimeve shëndetësore, sipas kalendarit të zgjedhjeve të OIK-ut, zgjedhje për përfaqësim në Oda të Infermiereve janë mbajtur edhe në Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare "Rexhep Kuçi", ku në garë ishin tre kandidat, dhe përfaqësues për infermier në oda do të jetë znj. Arbërije Kolgeci si më e votuara.

Këshilli drejtues këtë muaj ka mbajtur takime të rregulla ku ka diskutuar për sistemin dhe mbarvajtjen në punë, shqyrtimin e kërkesave të punëtorëve shëndetësorë etj. Takim urgjent këshillit drejtues është mbajtur për të shqyrtuar rastin i cili është bërë i ditur edhe përmes mjeteve të informimit për QMF-Duhël, ku ka ndodhur një lëshim nda një pacientit të cilit i është ofruar medikament me afat të skaduar. Mjekut dhe infermierit i është shqiptuar denim nga Inspektoriati Farmaceutik, gjithashtu për rastin në fjalë është mbajtur takim me këshillin drejtues për masat të cilat do të ndërmerren.

Më datë 23.02.2023 në kuadër të Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional, në QKMF "Rexhep Kuçi", është mbajtur ligjerata me temën "URUSTOMA", ku morrën pjesë infermierë, mami dhe profesionistë të tjerë shëndetësor, kjo ligjerat përveq njohurive të cilat i përfitojnë profesionistët shëndetësor, ato do të ju shërbejnë edhe për pike për rilicencim në të ardhmën.



Këtë muaj nga listat e branave esenciale nga Ministria e Shëndetësisë, ne si KPSH jemi furnizuar me disa nga barnat të cilat figurojnë në list, apo shprehur në vlera dhe përqindje nga 200 produkte medicinale jemi furnizuar me 51 artikuj, apo 25% si përmbledhje e përgjithshëm.

Ne si menaxhmet kemi përgaditur listen për furnizim me barna në bashkpunimi me farmacisten përgjegjëse dhe personeli tjetër shëndetësor ku prite së shpejti iniciimi i procedurës së prokurimit. Kjo listë e barnave do të fuqizonte edhe me tepër rritjen e cilësisë në KPSH.

Në kuadër të Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional, me datë 28.02.2023 në sallën e trajnimeve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Rexhep Kuçi", është mbajtur ligjerata me temën - "DHUNA NË FAMILJE".

Dr.Sherif Aliaj-Specialist i Psikiatrisë, tregoj për faktorët që shpiten drejt dhunës fizike dhe psikologjike në familje.

Në këtë ligjeratë morrën pjesë mbi 80 infermierë, mami dhe profesionistë të tjerë shendetesor.



Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Rexhep Kuçi" në kuadër të punëve dhe detyrave konform Ligjit dhe Statutit të QKMF-së, ka kryer shërbime të ndryshme të cilat janë të parapara.

Këtë periudhë kohore nga data 13/03/2023 deri më sot datë 17/03/2023, ne kemi bërë vizita dhe takime të ndryshme.

Me datë 13/03/2023 kam vizituar nga afer QMF-Bukosh dhe QMF Mushtisht, ku jam njoftuar me rrjedhën e shërbimeve, furnizimeve me barna si dhe angazhimi i stafit në ofrimin e shërbimeve shendetesore.

Me date 14/03/2023 kam takuar profesionistët shendetesor të Njesisë së gjinekologjisë Dr. Adem Halitaj dhe mamitë prezente ku diskutuam për mënyrën dhe procesin e implementimit të shërbimit të Pap-tes. Gjatë diskutimit i sigurova që kërkesat e tyre në furnizim me material shpenzues dhe mënyrën e ruajtjes dhe transportit të materialit do të jenë prioritet i institucionit.

U dakordua rreth termineve dhe përparësive që do të kenë gratë e deshmorëve, veteraneve, dhe rastet sociale.

Me date 14/03/2023 si dhe date 16/03/2023 nën organizimin e trajnimeve të EVP u mbajt ligjerata me titull: "Vendosja e kanilës" nga infermieri i urgjencës Xhavit Bytyqi.

Me date 14/03/2023 nën organizimin e Ministrisë së Shëndetësisë në hapsirat e Telemjekësisë QKUK Pr u mbajt trajnim për sistemin SISH Bhss aplikacioni për infermieret të cilët janë të angazhuar në vizitat në shtëpi për gra shtatzena dhe fëmijë 0-3 vjeq në dy grupe të ndara gjithsej 13 infermier dhe kordinatorja e këtyre vizitave në shtëpi.

Me date 15/03/2023 ka filluar implementimi i procesit të shërbimit të Pap-test ku u janë ofruar pesë (5) grupe për shërbim të rëndësishëm të veçantë.

Me date 15/03/2023 se bashku me Trajneret e EVP dhe kemi vizituar QKMF Dragash ku u pritem nga Drejtori dhe Trajneret e EVP ku u njoftuam per se afermi me sherbimet dhe aktivitetet qe ofrojne ky institucion.

Me date 15/03/2023 Barnatorja qendrore eshte furnizuar me barna dhe material shpenzues nga OE Madekos sipas kerkeses se Farmacistes kryesore.

Pregaditja e procedures se prokurimit per material higjienik, pajisje tjera,per EVP per punetoret shendetesor,asgjesimi i barnave dhe matialit me afat te skaduar.

Me datë 16/03/2023 planifikimi dhe organizimi per sigurimin e shportave per procesin e ndarjes selektimit te barnave materialit shpenzues me afat te skaduar.

Me date 17/03/2023 ka filluar te zbatohet marreveshja me shkollen IAA"Abdyl Ramaj"per praktiken e nxenesve te kesaj shkolle te drejtimit Bashkepunetor profesional i infermierise.

Qendra Kryesore e Mjekesise Familjare"Rexhep Kuqi" në kuadër të punëve dhe detyrave konform Ligjit dhe Statutit të QKMF-së, ka kryer shërbime të ndryshem te cilat janë të parapara.

Këtë periudhe kohore nga data 20/03/2023 deri më sot datë 24/03/2023, ne kemi bërë vizita dhe takime të ndryshme.

Me date 20/03/2023 mbajtja e mbledhjes se Keshillit Drejtues: planifikimi i vizitave sistematike,kerkese DSHMS per pajisje me Libreza Sanitare,shqyrtimi i kerkesave ankesave te ndryshme.

Me datë 23/03/2023 kemi vizituar nga afer AMF-Nishor dhe AMF-Semetisht ku jemi njoftuar me rrjedhën e sherbimeve,furnizimeve me barna si dhe angazhimi i stafit ne ofrimin e sherbimeve shendetesore si dhe analizimin e gjendjes per rifunksionalizimit te AMF Semetisht.

Gjat javes kam takuar profesionistet shendetesor te Njesise se gjinekologjise ku diskuatuum per menyren dhe procesin e mbarvajtjes se sherbimit te Pap-test.Gjat diskutimit u vu ne theks te veqante kerkesat e medha te qytetareve per kete sherbim.

Me date 23/03/2023 nen organizimin e trajnereve te ZHVP dhe EVP per qellim te shenimit te Dites Boterore te Tuberkulozit u mbajt ligjerate me titull:"Tuberkulozi" nga Pulmologia Dr.Sevim Brina.

Edhe gjate kesaj jave nga infermieret e trajnuara jan ofruar Vizitat ne shtepi per grate shtatzena dhe femije 0-3 vjeq.

Me date 22/03/2023 Barnatorja qendrore eshte furnizuar me Insulina sipas kerkeses se Farmacistes kryesore.(nuk jemi furnizuar me Insulina Levemir)

Edhe gjat kesaj jave komisioni ka vazhduar te kryej ndarjen, kategorizimin, plotsimin e listave per procesin e asgjesimit barnave dhe matialit me afat te skaduar.

Ne bashkepunim me Drejtorine e Sherbimeve Publike jemi furnizuar me shporta per procesin e ndarjes selektimit te barnave materialit shpenzues me afat te skaduar.

Kerkese per Inspektoriatin Farmaceutik per procesin e verifikimit dhe monitorimit te stokut te barnave me afat te skaduar.

Mbajtja e mledhjes se keshillit Drejtues te QKMF shqyrtimi i kerkesave ankesave te punetoreve te ndryshme..

Pregaditja dhe ofrimi i Listes se punetoreve te QKMF ne Qendren Rajonale te ISHP Prizren per planifikim dhe kordinim te analizave mikrobiologjike per proceduren e pajisjes me Libreza Sanitare per te gjithë punetoret qe ofrojne sherbime ne QKMF ne baze te marreveshjes se arritur.

Këtë periudhe kohore nga data 24/03/2023 deri më sot datë 31/03/2023, ne kemi bërë vizita dhe takime të ndryshme.

Me date 27/03/2023 mbajtja e mbledhjes me trajneret e ZHVP dhe EVP per kordinimin si dhe pregaditja e listave pjesemarrrese te punetoreve shendetesor per trajnimin e radhes me kerkese te Min.ShendetesiseKeshillit Drejtues.

Kordinimi me Drejtorine e Qendres Rajonale te Shendetit Publik rreth organizimit te testeve mikrobiologjike per pajisje me librezat sanitare per punetoret e QKMF.

Gjat javes kam takuar profesionistet shendetesor te Mjekesise familjare ku diskutuam per menyren dhe procesin e ndryshimit te mundeshem te orarit te punes.

Komisioni per korigjimin,pershtatjen e te dhenave konform procesit te klasifikimit te vendeve te punes edhe gjat kesaj jave ka mbajtur takime te vazhdueshme dhe ka derguar ne institucionet relevante perkatese plotesim ndryshimet e nevojshme per punetoret e QKMF.

Edhe gjate kesaj jave nga infermieret e trajnuara jan ofruar Vizitat ne shtepi per grate shtatzena dhe femije 0-3 vjeq.

Me date 30/03/2023 Barnatorja qendrore eshte furnizuar me barna dhe material shpenzues e qe nje furnizim i tille nuk i ploteson nevojat e institucionit tone as per se afermi.

Edhe gjat kesaj jave komisioni ka vazhduar te kryej ndarjen, kategorizimin, plotsimin e listave per procesin e asgjesimit barnave dhe matialit me afat te skaduar.

Aprovimi i dy kerkesave te mjekeve te pergjitheshem per pune vullnetare pran QKMF.

Pregaditja dhe caktimi i grupeve te ndara te punetoreve te QKMF per analizat mikrobiologjike per proceduren e pajisjes me Libreza Sanitare per te gjithë punetoret qe ofrojne sherbime ne QKMF ne baze te marreveshjes se arritur.

So me date 31.03.2023 ne kuader te Zhvillimit te vazhdueshem profesional eshte mbajtur ligjerata me titull "Osteoporoza" nga Prof.Dr.Ismet bajraktari Specialist i Reumatologjise.

Si cdo fillim të muajit njoftohen të gjithë qytetarët të cilët janë Insulinëvartës se Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare është furnizuar me Insulina dhe të njëjtit mundë të furnizohen me to, ndërsa kë muaj për arsye të mos furnizimit me kohe nga Ministria ky njoftim është bere me vones.



Ashtu edhe siç ka qenë e planifikuar me planin e punës të QKMF-së, në skurt është implemetuar dhe funksionalizuar projekti i SISH-it, ku e gjithë Mjekësia Familjare, Vaksinimi, Urgjenca janë duke e implemetuar këtë program, gjithashtu të gjitha QMF-t janë paisur me paisje për të funksionuar programin e SISH-it, ku deri në Marsë synojm të implementohet në të gjitha qendrat e QMF-ve.

Në kuadër të Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional, me datë 14, dhe 16 Mars, 2023 në QKMF "Rexhep Kuçi", është mbajtur ligjerata me temën "Vendosja e Kanillës", ku morrën pjesë infermierë, mami dhe profesionistë të tjerë shëndetësor.

Ligjeratat anë mbajtur nga Xhavit Bytyqi



Me qëllim të shënimit të Ditës Botërore të Tuberkulozit si dhe në kuadër të Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional, me datë 23.03.2023 në sallën e trajnimeve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Rexhep Kuçi", është mbajtur ligjerata me temën - "TUBERKULOZI"

Dr. Sevim Brina - Specialiste e Pulmologjisë tregoj për faktorët pasqyrën klinike dhe trajtimin e kësaj sëmundje. Ajo theksoi se është mjaft shqetsuese për komunën tonë sepse sipas të dhënave statistikore në kemi një numër në rritje të prekurve me këtë sëmundje nga vitet paraprake.

Në këtë ligjeratë morën pjesë mjekë, infermierë, mami dhe profesionistë të tjerë shëndetësor.

Faleminderit Dr. Sevim Brina Pulmologe.



Këtë muaj nga lisat e branave esenciale nga Ministria e Shëndetësisë, ne si KPSH jemi furnizuar me disa nga barnat të cilat figurojnë në list, apo shprerur në vlera dhe përqindje nga 200 produkte medicinale jemi furnizuar me nje nr te vogel te barnave qe as per se afermi nuk l ploteson kerkesat e institucionit. Ne si menaxhmet kemi përgaditur listen për furnizim me barna në bashkpunimi me farmacisten përgjegjëse dhe personeli tjetër shëndetësor ku prite së shpejti iniciimi i procedures së prokurimi.Kjo listë e barnave do të fuqizonte edhe me tepër rritjen e cilësisë në KPSH.

Me datë 29.03.2023 kemi pritur nxënësit parashkollorë të SHMFU "7Marsi" bashkë me edukatoret e tyre vizituan sot QKMF-n. Ata u njoftuan me shërbimet e pediatriisë, stomatologjisë dhe urgjencës!



Në kuadër të Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional, me datë 01, Prill, 2023 në QKMF "Rexhep Kuçi", është mbajtur ligjerata me temën "OSTEOPOROZA", ku morrën pjesë infermierë, mami dhe profesionistë të tjerë shëndetësor.

Dr.Ismet Bajraktari Specialist i Reumatologjisë tregoj për faktorët pasqyrën klinike dhe trajtimin e kësaj sëmundje.



Këshilli drejtues këtë muaj ka mbajtur takime të rregulla ku ka diskutuar tema të ndryshme, bazuar në kërkesa të profesionistëve shëndetësor, gjithashtu edhe sipas planit të punës, ndër të tjera e një rëndësie të veçant përgaditja e planit për Imunizim dhe Vizita Sistematike.

Të dyja këto shërbime kanë filluar sipas planifikimit të paraparë ku me datë 28.04.2023 kanë filluar me Imunizimin ndërsa me datë 02.05.2023 kanë filluar me Vizitat Sistematike në Shkollë.

Gjat këtij muaji janë bërë analizat mikrobiologjike për të gjithë profesionistët shëndetësor në bashkëpunim Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik – Qendra Rajonale Prizren.

Gjithashtu janë bërë vizita edhe AMF-ve në Sopijë, Dubarvë dhe Greikoc, për të parë nga funksionimin dhe mbarvajtjen e punës.

Me datë 8, Prill, 2023 është pensionuar një motër shumë e respektuar për të gjithë ne, e cila për një kohë të gjatë ka shërbyer si mami në institucionin tone.

Pensionimin e motrës Zyrafete Dakaj në emër të kryetarit e ka përshëndetur nënkryetarja znj. Mihrije Suka, gjithashtu edhe drejtoresha e DSHMS-së znj. Besa Kuçi.



Për të gjithë infermierët, mami, dhe profesionistët tjerë shëndetësor QKMF "Rexhep Kuçi" në Suharekë, ka mbajtur ligjerat me temën "DIABETI-DIABETES".

Ligjerata është mbajtur në sallën e ligjeratave në QKMF "Rexhep Kuçi"-Suharekë.

Ministria e Shëndetësisë në kuadër të procesit të vlerësimit të materniteteve në KPSH, si dhe grumbullimin e të dhënave, me datë 13, Prill, 2023 në sallën e trajnimeve në QKMF "Rexhep Kuçi" ka zhvilluar takim me fokus grupin e grave të Komunës së Suharekës.

Zyrtaret nga Ministria e Shëndetësisë Dr. Merita Vuthaj dhe Dr. Albana Morina në mbështetje të Elvanda Gojani nga AMC dëgjuan përvojat e grave shtatzëna dhe nënave të reja për shërbimet në maternitetin e QKMF-së si dhe vizitat në shtëpi.

Ne mbesim të përkushtuar në realizimin sa më të mirë të projektit të vizitave të nënave dhe fëmijëve!



QKMF "Rexhep Kuçi" ju bashkua aktivitetit për pastrim të ambientit, njëherit jemi dhe mbetemi të përkushtuar të kemi ambient të pastër. Një vend i pastër, është dëshmi e pastërtisë së mendjes dhe ndërgjegjes.



Gjithashtu në prill janë zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e OE për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional, i cili është mbajtur në Vlorë të Shqipërisë.

[Me datë 25.04.2023 në QKMF "Rexhep Kuçi", ka filluar realizimi i projektit të energjisë alternative.](#)

[Zhvillimi i energjisë solare dhe teknologjisë, kanë bërë që të jetë e mundshme ta kemi në secilën shtëpi, institucion mundësin ti kursejmë faturat duke prodhuar vetë energjin që na duhet, përmes vendosjes së paneleve fotovoltaike.](#)

[Ky projekt financohet nga UNDP dhe realizohet nga OE "Rata Solar"](#)



Me datë 28.04.2023 profesionistët shëndetësor të QKMF "Rexhep Kuçi" kanë filluar imunizimin (vaksinimin) e nxënësve të klasëve të para (I) dhe klasëve të gjashta (VI) në Shkollën Filllore "Shkëndija" në Suharekë. Nxënësit do të vaksinohen sipas kalendarit të rregullt të vaksinimit në të gjitha shkollat fillore të komunës tonë. Vaksinimi jo vetëm që i mbron fëmijët tuaj, por parandalon edhe shpërthimin e epidemive në shkollë. Vaksinimet e rregullta për fëmijët janë të sigurta dhe efektive. Ato janë testuar tërësisht nga OBSH-ja dhe është provuar se parandalojnë sëmundje të rënda, duke shpëtuar miliona jetë fëmijësh çdo vit. Me vaksinimin e rregullt, fëmijët zhvillojnë mbrojtje afatgjatë për të pasur një jetë të shëndetshme dhe cilësore.



Shëndeti primar, ishte mote e vizitave sistematike në të gjitha shkollat e komunës së Suharekë, në bashkëpunim me drejtorinë e arsimit drejtorin z.Remzi Bajselmanaj dhe drejtorët e të gjitha shkollave. Vizitat sistematike janë duke u realizuar edhe në disa vendbanime të komunës tonë.



Në Ditën Ndërkombëtare të Infermierisë QKMF organizoj ligjerat për gjithë profesionistët shëndetësor me temën "DITA BOTRORE E SHËNDETIT-IMUNIZIMI", ku ligjeroj dr.Donika Meta, gjithashtu aktivitet senzibilizuese, këshilla mjekësore për gjithë qytetarët në sheshin e qytetit.

Infermierët janë uruar nga menaxhmenti për punën dhe angazhimin e tyre të palodhur.

"Një infermier/e nuk është një shërbëtor, por një specialist i certifikuar. Por jo vetëm. Infermieri/ja është këmbët e pakëmbëve, duart e të pa krahëve, sytë e të verbërve, goja e memecit, mbështetja e të dobët, ndihma e nënës, infermierja e foshnjës. Një infermier/e është gjithashtu një psikologe që dëgjon dhe ndihmon".



Në ditën QKMF-së dhe Ditën e Mjekut Familjarë, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Rexhep Kuçi", u mbajtën aktivitete të ndryshme si:

- Vizitë nga nxësit e Shkollës së Mesme "Abdyl Ramaj" - profili i infermierisë,
- Matje e tensionit dhe sheqerit në sheshin e qytetit,
- Mbjellja e luleve në oborrin e QKMF-së
- Ceremoni e ndarjës së mirënjohjeve për programin "Shtretërit Shtëpiak" dhe punëtorëve të dalluar.

Në ceremonin e organizuar, para ndarjës së mirënjohjeve, dr.Sale Bytyqi i falenderoj të pranishmit për pjesëmarrje, znj.Mihrije Suka-nënkryetare e komunës, drejtorët e drejtorive, familjarët e të ndjerit Rexhep Kuçi, KFORIN, Caritasin, Handikosin etj, e në veçanti kryetarin e komunës z.Bali Muharremaj për mbështetje në ndërtimin e objekteve të reja dhe moderne, apatartuarve të ndryshme etj.

Ajo falenderoj profesionistët shëndetësor të cilët në periudha të ndryshme kontribuan në rritjen e profesionalizmit të shëndetësisë.





Me datë 26.05.2023 në kuadër të Programit të "Vizitave në Shtëpi" QKMF"Rexhep Kuçi" në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe mbështetje nga UNICEF dhe AMC ka pranuar donacion një laptop dhe 22 tabletë. Ky donacion do të i shërbej institucionit ton për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore të ofruara përmes programit të vizitave në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0-3 vjeç.



Me datë 31.05.2023, në ora 15:00, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Rexhep Kuçi", në kuader të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, është mbajtur ligjerata me temën:

"Gastroenterokolitet".

Kjo ligjerat është mbajtur nga dr. Safete Shurdhaj (Pediater)



"Kontrollet dhe kujdesi në shtatëzani", ishte tema që infermierja Valza Vataj mbajti ligjeratë për personelin e mesëm shëndetësorë, infermier, mami dhe profesionist të tjerë shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Rexhep Kuçi" në Suharekë.



" GJENDRA TIROIIDE" ishte tema që infermierja Arberije Kolgeci mbajti ligjeratë për personelin e mesëm shëndetësorë, infermier, mami dhe profesionist të tjerë shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Rexhep Kuçi" në Suharekë.



Me datë 24 dhe 25 është punuar në menyr intensive për funksionalizimin e AMF-së në Bllacë, në mënyr që banoret e atyre zonave mos të mbesin pa shërbime shëndetësore, deri në rregullimin e QMF-së në Duhël.



PROJEKTI SHTRËTËRIT SHTËPIAK

Projektit "Shtretit Shtëpiak", me Dr.Behare Elshani, infermieret Ilirjana Gegaj dhe Adelina Elshani, është një projekt i cili ka një rëndësi tejet të madhe sidomos për pesona në moshë, pesona të vetëmuar apo pa përkujdesje.

Ky projekt i filluar në vitin 2009-2010 si projekt inovativ i asaj kohe, tani projekt i domosdoshëm, ku qytetarët kanë një vlerësim tejet të lartë për përkushtimin ndaj tyre.

PROJEKTI SHTRËTËRIT SHTËPIAK

DEPARTMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSH	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
GJITHSEJ VIZITA	227	215	239	217	774	804							2476
PASTRIM I PLAGËVE	41	64	62	86	124	132							509
INJEKSIONE	71	55	77	51	57	62							373
INFUZIONI	96	71	74	50	68	75							434
KATETERET URINAR	27	32	40	31	63	58							251
GLIKEMIA	62	70	68	107	103	120							530
PERSONA TE VETMUAR	52	55	49	52	76	72							356
R.A.E	15	18	9	8	9	12							71
SHERBIMET	591	500	618	602	774	1335							4420
VIZIT E DYT					124	201							



REGJISTRIMI I VIZITAVE NE SHTEPI PËR GRA SHTATZËNA DHE FËMIJË 0-3 VJEÇ 2023

Komuna e	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
Numri i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç	83	123	93	51	37	65							452
Numri i vizitave në shtëpi për shtatzëna	20	28	25	25	12	14							124
Numri total i vizitave në shtëpi të kryera	103	151	118	76	49	79	0	0	0	0	0	0	576
Nr. i fëmijëve vajza 0-3 vjeç të cilat janë vizituar për herë të parë	38	53	36	14	10	20							171
Nr. i fëmijëve djem 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	34	53	24	14	8	15							148
Nr. total i fëmijëve 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	72	106	60	28	18	35	0	0	0	0	0	0	319
Numri i vizitave të dyta për fëmijët 0-3 vjeç	23	44	25	16	13	25							146
Numri i vizitave të treta për fëmijët 0-3 vjeç		7	8	1	7	5							28
Numri i vizitave të ketërta për fëmijët 0-3 vjeç													0
Numri i vizitave të pesta për fëmijët 0-3 vjeç													0
Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes	27	19	18	11	15	5							95
Numri i shtatzënave që janë vizituar për herë të parë	9	18	16	14	7	8							72
Numri i shtatzënave që kanë pranuar vizitën e dytë	11	9	7	11	4	6							48
Numri i fëmijëve 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	4	1		2	1								8
Numri i grave shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	3	1		2									6
Numri i fëmijëve të referuar tek specialistët mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare	5	1		4	2								12
Numri i vizitave shitesë për fëmijë dhe shtatzëna (jashtë standardit të programit të vizitave në shtëpi)	2	1	1	1									5
Numri i baballarëve të përfshirë gjatë vizitave në shtëpi	23	49	32	12	19	20							155
Numri i rasteve sociale të identifikuara dhe të referuar	4	2	1	3	3								13
Numri i rasteve të dhunës të identifikuara (nga observimi gjatë vizites në shtëpi)													0
Numri i fëmijëve të identifikuar me ngecje në zhvillim dhe të referuar (nga observimi gjatë vizites në shtëpi)													0
Numri i infermierëve që janë angazhuar në zbatimin e vizitave në shtëpi	22	20	21	16	12	12							103

Program tjetër i një rëndësi të veçantë është përkujdesi nga **Nënave dhe Fëmijëve në Shtëpi**, i cili çdo ditë e më tepër po avancohet, falë punës dhe angazhimit të profesionistëve shëndetësor.



Sektori i Mjekësisë Familjare

Në sektorin e Mjekësisë Familjare në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi janë kryer këto shërbime si në table:

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSH	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
MJEKËSIA FAMILJARE	6502	5280	5126	4363	4595	5436							31302
RADIOLOGJIA	277	293	274	162	65	102							1173
ULTRAZË	101	111	81	45	21	18							377
LEXIM R.T.G	198	177	181	109	2	60							727
STOMATOLOGJIA	286	223	245	172	288	215							1429
URGJENCA	7175	5747	6756	6118	6140	6613							38549
RENTGENI	761	695	891	618	824	780							4569
MAMOGRAFI	13	14	20	12	7	5							71
LIDHTOJRA	541	410	376	536	676	701							3240
GJINEKOLOGJIA	223	208	222	190	255	220							1318
ULTRAZË	207	198	216	188	246	215							1270
LINDJE	1	0	2	1	1	3							8
LABORATORI	12721	7918	9477	9978	12486	12850							65430
INJEKSIONET	4410	3523	3105	2986	2823	2736							19583
INFUZIONET	1563	1433	1311	1286	1150	1620							8363
INHALIMI	119	69	78	64	29	30							389
EKG	178	117	79	99	101	13							587
BARNATORE	858	519	521	312	695	630							3535
REFERIMET	368	345	307	339	288	320							1967
PEDIATRIA	262	368	422	120	349	0							1521
VIZIT E DYT	141	153	141	150	131	126							842
SHERBIMET	36905	27801	29831	27848	31172	32693							186250

QMF MUSHTISHT

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSH	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
VIZITAT MJEKSORE	601	524	621	471	507	601							3325
INFUZIONET	126	117	125	51	72	85							576
INJEKSIONET	326	327	345	195	270	301							1764
INHALIM	5	15	15	0	0	0							35
LIDHJE	70	63	0	56	104	107							400
EKG	0	0	0	0	0	0							0
STOMATOLOGJIA	85	88	89	58	72	69							461
GLIKEMIA	0	0	0	4	3	2							9
REFERIME	107	81	100	105	125	100							618

QMF BUKOSH

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHC	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
VIZITAT MJEKSORE	709	522	589	469	523	530							3342
INFUZIONET	223	159	147	83	267	301							1180
INJEKSIONET	410	264	310	260	132	390							1766
INHALIM	1	3	6	3	5	4							22
LIDHJE	63	78	107	86	100	98							532
EKG	13	15	10	12	8	7							65
STOMATOLOGJI	46	34	28	27	46	52							233
GLIKEMIA	8	13	14	8	12	15							70
REFERIMET	59	57	83	46	53	50							348

QMF DUHEL

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHC	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
VIZITAT MJEKSORE	844	796	817	542	686	701							4386
INFUZIONET	169	163	201	430	128	150							1241
INJEKSIONET	599	547	420	79	413	480							2538
INHALIM	0	0	0	0	0	0							0
LIDHJE	74	70	95	75	82	98							494
EKG	8	7	12	8	10	9							54
STOMATOLOGJI	39	58	49	44	45	26							261
GLIKEMIA	0	0	0	0	0	0							0
REFERIMET	9	14	11	10	19	15							78
Laboratori	88	134	142	512	86	23							985

QMF GJINOC

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHC	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
VIZITAT MJEKSORE	358	310	374	255	321	310							1928
INFUZIONET	71	106	93	76	48	58							452
INJEKSIONET	170	186	258	156	150	201							1121
INHALIM	3	0	10	0	2	3							18
LIDHJE	17	27	36	25	31	45							181
EKG	2	0	4	0	2	3							11
STOMATOLOGJI	20	21	41	15	12	13							122
GLIKEMIA	11	16	12	12	8	9							68
REFERIMET	83	61	58	69	89	56							416
R.A.E	29	16	37	18	16	12							99

QMF STUDENÇAN

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHC	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJITHSEJ
VIZITAT MJEKSORE	904	775	880	637	704	720							4620
INFUZIONET	138	114	168	103	76	85							684
INJEKSIONET	368	376	396	287	352	320							2099
INHALIM	13	16	10	7	10	11							67
LIDHJE	48	53	88	62	53	60							364
STOMATOLOGJI	86	66	44	21	52	62							331
EKG	18	19	26	0	0	0							63
GLIKEMIA	0	0	0	0	0	0							0
REFERIMET	110	96	127	93	86	78							590
LABORATORI	88	115	252	121	75	80							731

AMF MOHLAN

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJTIHSEJ
VIZITAT MJEKSORE	156	155	185	129	171	185							981
INFUZIONET	17	20	28	14	31	38							148
INJEKSIONET	96	111	99	64	73	89							532
INHALIM	6	3	15	2	2	3							31
LIDHJE	33	17	32	33	23	29							167
EKG	0	0	0	0	0	0							0
REFERIME	308	12	17	11	5	9							362

AMF LESHAN

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJTIHSEJ
VIZITAT MJEKSORE	0	103	8	0	88	98							297
INFUZIONET	4	11	3	5	6	15							44
INJEKSIONET	17	60	42	22	25	38							204
INHALIM	0	0	0	0	0	0							0
LIDHJE	4	9	13	7	5	8							46
GLIKEMIA	0	0	0	0	0	0							0
EKG	0	0	0	0	0	0							0
REFERIME	0	66	5	0	0	5							76

AMF GREIKOC

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJTIHSEJ
VIZITAT MJEKSORE	101	54	95	27	36	45							358
INFUZIONET	15	10	6	37	13	10							91
INJEKSIONET	53	81	41	2	55	68							300
INHALIM	0	0	0	0	0	0							0
LIDHJE	33	12	46	41	31	45							208
GLIKEMIA	0	0	0	0	0	0							0
EKG	0	0	0	0	0	0							0
REFERIME	0	0	0	0	0	0							0
SHERBIMET	202	157	188	107	135	168							957

AMF SALLAGRAZHDE

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJTIHSEJ
VIZITAT MJEKSORE	82	40	82	100	83	102							489
INFUZIONET	24	35	26	36	134	98							353
INJEKSIONET	104	79	79	78	24	102							466
INHALIM	1	1	32	0	0	3							37
LIDHJE	9	23	18	19	29	41							139
GLIKEMIA	0	0	2	1	0	2							5
EKG	0	0	0	0	0	0							0
REFERIME	28	5	9	25	31	20							118
SHERBIMET	248	183	248	259	301	368							1607

AMF NISHOR

DEPARTAMENTET	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	GJTIHSEJ
VIZITAT MJEKSORE	90	0	119	0	0	0							209
INFUZIONET	17	18	18	9	10	9							81
INJEKSIONET	44	70	69	24	52	31							290
INHALIM	0	0	0	0	0	0							0
LIDHJE	30	28	32	16	35	40							181
GLIKEMIA	0	0	0	0	0	0							0
EKG	0	0	0	0	0	0							0
REFERIME	0	0	0	0	0	0							0
SHERBIMET	181	116	119	49	97	80							642

RAPORTI I PUNËS NË LABORATOR STUDENQAN 2023

MUAJI →	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	dhjetor	GJITHSEJ
HEMOGRAM	35	41	50	40	16	15							197
SEDIMENT I ERITR.	14	9	13	13	2	3							54
GLUCOZA	52	50	62	53	50	58							325
UREA	0	0	0	0	0	0							0
KREATININA	0	0	0	0	0	0							0
TRIGLICERIDET	0	0	0	0	0	0							0
HOLESTEROLI	0	0	0	0	0	0							0
AST(GOT)	0	0	0	0	0	0							0
ALT(GPT)	0	0	0	0	0	0							0
BILIRUBINA TOTALE	0	0	0	0	0	0							0
BILIRUBINA DIREKTE	0	0	0	0	0	0							0
FE-HEKURI	0	0	0	0	0	0							0
CRP	0	0	0	0	0	0							0
ASTO	0	0	0	0	0	0							0
RF	0	0	0	0	0	0							0
KOHA E KOAGULIMIT	0	0	0	0	0	0							0
URINA	19	15	20	0	14	15							83
HbA1C	0	0	0	0	0	0							0
Numri I Pacientave	88	88	107	100	75	89							547
Numri I sherbimeve	120	115	252	120	82	102							791

RAPORTI I PUNËS NË LABORATOR DUHËL 2023

MUAJI →	janar	shkurt	mars	prill	maj	qersh	korrik	gusht	shtat	tetor	nentor	dhjetor	GJITHSEJ
HEMOGRAM	33	38	38	8	20	0							137
SEDIMENT I ERITR.	24	29	32	14	36	3							138
GLUCOZA	20	39	37	14	0	16							126
UREA	0	0	0	0	0	0							0
KREATININA	0	0	0	0	0	0							0
TRIGLICERIDET	0	0	0	0	0	0							0
HOLESTEROLI	0	0	0	0	0	0							0
AST(GOT)	0	0	0	0	0	0							0
ALT(GPT)	0	0	0	0	0	0							0
BILIRUBINA TOTALE	0	0	0	0	0	0							0
BILIRUBINA DIREKTE	0	0	0	0	0	0							0
FE-HEKURI	0	0	0	0	0	0							0
CRP	0	0	0	0	0	0							0
ASTO	0	0	0	0	0	0							0
RF	0	0	0	0	0	0							0
KOHA E KOAGULIMIT	0	0	0	0	0	0							0
URINA	22	28	35	16	29	4							134
HbA1C	0	0	0	0	0	0							0
Numri I Pacientave	35	57	55	28	40	16							231
Numri I sherbimeve	99	134	142	62	86	23							546

Raporti nga vizitat sistematike të klasave të para, pesta dhe të nënta në Komunën e Suharekës

Fëmijët e moshës shkollare janë kategori e veçantë për shkak të rritjes dhe zhvillimit aktiv karakteristike për moshën, prandaj si kategori e veçantë që janë kërkojnë edhe kujdes të veçantë shëndetësor.

Qëllimet e vizitave sistematike

1. Vlerësimi i nivelit të rritjes dhe zhvillimit të grupmoshës së caktuar, përkatësisht nxënësve të klasave të para të shkollave fillore;
2. Njohja dhe identifikimi i veçorive specifike të problemeve shëndetësore të kësaj grupmoshe, që do të mundësojë zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe anomalive/çrregullimeve eventuale te fëmijët;
3. Dizajnimi dhe organizimi i intervenimeve me natyrë preventive, të bazuara në shkolla dhe komunitet;
4. Krijimi i një baze të të dhënave nga rezultatet e vizitave të realizuara e cila do të mbështesë modifikimin dhe përpilimin e politikave shëndetësore më favorizuese për fëmijët.

Parametrat e vlerësuar:

Është vlerësuar zhvillimi i përgjithshëm psikofizik dhe shëndeti oral
Kronologjia e aktiviteteve

Matja e peshës trupore dhe gjatësisë (vlersim standard sipas diagramit)

Kontrolli i të pamurit sipas tabelës (Snellen).

Të dëgjuarit.

Kontrolli detal klinik i lëkurës , kokës , hundës gojës, dhëmbëve, gjëndrës tyroide, zemrës, mushkërive, barkut, ekstremiteteve, boshtit kurizor, gjoksit.

Zhvillimi psiko- motorik e pjekuria sociale dhe emotive

Planifikimi i vizitave sistematike :

Sigurimi i materialit dhe mjeteve të punës

Përgatitja e ekipeve mjekësore

Realizimi i vizitave sistematike

Përpunimi i formularëve të vizitave

Mbikëqyrja dhe kontrolli i projektit

Evaluimi i projektit

Të dhënat e përgjithshme statistikore :

Numri i përgjithshëm i nxënësve të evidentuar :**2192**

Numri i nxenesve te klasave te para :**689**

Numri i nxenesve te klasave te pesta :**786**

Numri i nxenesve te klasave te nenta:**717**

Data e fillimit te vizitave sistematike :**02.05.2023**

Data e mbarimit te vizitave sistematike :**07,06.2023**

Përbërja e ekipit punues:

Koordinator i ekipeve - 1

Mjek familjar – 1

Infermiere familjare – 2

Doktor i stomatologjisë –1

Asistente e stomatologut – 1

Numri i personelit të përfshirë në vizita

Ekipet mjekësore : 9

2 ekipe nga qendra QKMF-së dhe 7 ekipe nga QMF-të prej tyre 7 mjekë familjarë, 2 mjek te pergjithshem, 6 doktor te stomatologjisë, 16 infermiere familjare, 4 asistente të stomatologjisë

Raporti i ekipes mjekësore për vizitat sistematike- Suharekë

Shkollat :	Nr. i nxenesve te egzaminuar	Nr. i nxenesve me probleme shendetesore	Nr. i nxenesve me probleme me dhembe	Nr. i nxenesve te referuar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga Mjeku Familjar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga stomatologu
“ 7 Marsi “ Suharekë	162	3	99	1	2	122
“Destan Bajraktari” Suharekë	190	3	99	6	2	142
“Shkendija “ Suharekë	132	11	99	10	1	118
“Flamuri i Arberit “ Reshtan	38	4	39	8	2	22
Totali	522	21	336	25	7	404

Udhëheqësi i ekipit : Dr. Fatmire Bicaj

Raporti i ekipes mjekësore për vizitat sistematike- qendra Duhël

Shkollat :	Nr. i nxenesve te egzaminuar	Nr. i nxenesve me probleme shendetesore	Nr. i nxenesve me probleme me dhembe	Nr. i nxenesve te referuar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga Mjeku Familjar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga stomatologu
“Ramë Bllaca “ Bllacë	133	15	37	7	6	17
“Sadri Duhla “ Duhel	56	18	42	4	11	14
“Sadri Duhla “ Greqec	22	4	16	1	0	1
“Sadri Duhla “ Lagjja Sopa	16	3	16	2	0	1
“Ismet Jashari” Javor	23	6	22	1	3	4

Udhëheqësi i ekipit :Dr.Betim Iballi

Raporti i ekipes mjekësore për vizitat sistematike- Mushtisht, Maqitevë ,Sallagrazhe , Delloc

Shkollat :	Nr. i nxenesve te egzaminuar	Nr. i nxenesve me probleme shendetesore	Nr. i nxenesve me probleme me dhembe	Nr. i nxenesve te referuar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga Mjeku Familjar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga stomatologu
Edit Durham	110	2	28	14	5	46
Besim Ndrecaj	23	6	12	5	4	12
Gj. Kastrioti Skenderbeu	51	6	20	6	0	2
Edit Durham (Delloc)	4	0	0	0	0	16
Totali	188	14	60	26	9	76

Udhëheqësi i ekipit : Dr. Egzona Berisha

Raporti i ekipes mjekësore për vizitat sistematike- qendra Suharekë 2

Shkollat :	Nr. i nxenesve te egzaminuar	Nr. i nxenesve me probleme shendetesore	Nr. i nxenesve me probleme me dhembe	Nr. i xenesve te referuar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga Mjeku Familjar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga stomatologu
Xhavit Sylaj Sllapuzhan	34	0	27	11	46	46
Hasan Prishtina Semetisht	46	0	14	3	46	46
Deshmoret e Tivarit Peqan	35	0	37	17	35	38
Bajram Curri Nishor	46	0	21	5	38	46
Total	199	0	99	36	0	176

Udhëheqësi i ekipit : Dr.Sevdije Veselaj

Raporti i ekipes mjekësore për vizitat sistematike- Gjinoc

Shkollat :	Nr. i nxenesve te egzaminuar	Nr. i nxenesve me probleme shendetesore	Nr. i nxenesve me probleme me dhembe	Nr. i nxenesve te referuar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga Mjeku Familjar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga stomatologu
“V.P Shkodrani” Leshan	57	1	23	9	1	5
“Migjeni” Gjinoc	75	3	25	12	3	10
“Deshmoret e Grejkocit “ Grejkoc	105	2	47	15	2	4
“Drita” Gelancë	48	3	19	6	3	8
V.P Shkodrani Tërrnje	22	3	8	7	3	4
Total	307	12	122	49	12	31

Udhëheqësi i ekipit : Dr Sali Asllanaj

Raporti i ekipes mjekësore për vizitat sistematike- QMF-Stundençan

Shkollat :	Nr. i nxenesve te egzaminuar	Nr. i nxenesve me probleme shendetesore	Nr. i nxenesve me probleme me dhembe	Nr. i nxenesve te referuar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga Mjeku Familjar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga stomatologu
“28 Nentori “ Doberdelan	37	3	12	2	1	0
“Dituria “ Samadraxhë	96	2	43	0	0	11
“Rilindja “ Nepërbisht	23	1	11	1	0	3
“Kongresi i Manastirit “ Studençan	96	9	33	1	1	13
Total :	252	15	99	4	2	27

Udhëheqësi i ekipit : Dr.Muhamet Balaj

Raporti i ekipes mjekësore për vizitat sistematike- QMF Bukosh

Shkollat :	Nr. i nxenesve te egzaminuar	Nr. i nxenesve me probleme shendetesore	Nr. i nxenesve me probleme me dhembe	Nr. i nxenesve te referuar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga Mjeku Familjar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga stomatologu
“Vëllezërit Frashëri “ Bukosh	36	5	30	2	2	15
“Dëshmorët e Kombit “ Vraniq	65	12	39	5	5	32
“Dëshmorët e Kombit “ Popolan	5	1	11	0	0	5
“Iliria” Savrovë	39	11	21	6	6	18
Totali	145	28	101	13	13	65

Udhëheqësi i ekipit : Dr. Milit Elshani

Foto nga ekzaminimi Shiroke, Sopi.

PËRFUNDIM

Nga vlerësimi i rezultateve të dalta nga vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para, mund të konstatohet se në përgjithësi kemi të bëjmë me një kategori të popullatës (nxënës) të shëndoshë, përjashtimisht problemeve të shëndetit oral dhe patologjive refraktare të syve. Përndryshe, shkalla e përgjithshme e shprehur në përqindje e parametrave të vlerësuar me veçori patologjike në shumicën e parametrave është shumë e vogël (përjashtimisht dyshimit në çrregullimet refraktare të syve, mbipeshës, kariesit të dhëmbëve të qumështit dhe higjienës jo të mirë orale.

REKOMANDIMET

Duke u bazuar në rezultatet e nxjerra nga vizitat sistematike, janë nxjerrë rekomandimet si në vijim:

1. Promovimi i shëndetit oral dhe i kujdesit shëndetësor parandalues për ruajtjen e shëndetit të dhëmbëve nëpër shkolla, çerdhe dhe qendrat e mjekësisë familjare, duke demonstruar teknikën e pastrimit të dhëmbëve, me qëllim të parandalimit të kariesit të dhëmbëve;
2. Vulosja e dhëmbëve të përherëshëm dhe dhëmbëve të qumështit;
3. Fluorizimi i dhëmbëve;

Shkollat :	Nr. i nxenesve te egzaminuar	Nr. i nxenesve me probleme shendetesore	Nr. i nxenesve me probleme me dhembe	Nr. i nxenesve te referuar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga Mjeku Familjar	Nr. i nxenesve ne percjellje nga stomatologu
Naum Veqilharxhi Mohlan	51	05	25	2	10	06
Shkendija Reqan	15	9	02	8	9	07
Naum Veqilharxhi Stravuqin Krushice e eperme	19	6	12	6	4	05
Lidhja Prizrenit Budakove	56	8	29	1	8	03
Naum Veqilharxhi Vershec	02	02	0	02	02	02

4. Organizimi i kampanjave për edukimin dhe këshillimin e prindërve, fëmijëve parashkollorë, fëmijëve nëpër kopshte të tyre dhe nxënësve nëpër shkolla, lidhur me mënyrën e drejtë dhe të shëndetshme të ruajtjes së dhëmbëve dhe të ushqyerit e shëndetshëm;

5. Intensifikimi i bashkëpunimit ndërmjet infermiereve të QKMF- ve dhe infermiereve për edukim të komunitetit me Institutin e Shëndetit Publik, si dhe shpërndarja e broshurave për ushqyeshmërinë dhe të ushqyerit e drejtë;

6. Promovimi i stilit të shëndetshëm të jetës;

7. Inicimi i një bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve dhe profesionistëve shëndetësorë për hulumtimin, paraqitjen dhe menaxhimin e rasteve me çrregullime shëndetësore;

8. Vizitat sistematike të vazhdojnë edhe në vitin e ardhshëm (viti 2024), për klasën e I, V, IX.. Të shikohet mundësia e përmirësimit të higjienës në shkolla, duke rregulluar infrastrukturën e njeje sanitare, rrjetit të kanalizimit dhe furnizimin e rregullt me ujë.

9. Edukimi i fëmijëve për bartje të çantës dhe të qëndrimit në bankë.

10. Përqendrimi mbi shkaqet rrënjësore të problemeve të identifikuar dhe hartimi i strategjisë për adresim të saktë të problemeve, duke maksimalizuar përpjekjet për parandalim të devijimeve, të cilat janë të parandalueshme dhe për përmirësim të gjendjes. II. Përqendrim mbi partneritetin dhe bashkëpunimin e plotë dhe korrekt ndërmjet palëve të interesit në mes: Sektorit të shëndetit publik- drejtorisë së QKMF-së- DSHMS-së dhe MS- në mënyrë që të funksionojmë si ekip me qëllim të koordinimit të shërbimeve shëndetësore.

Koordinator i cilësisë :

Dr. Betim Iballi – Specialist i Mjekësisë Familjare

SHËRBIMET SOCIALE

Gjatë periudhës gjashtë mujore nga data 01.01.2023 e deri me datën 30.06.2023 në Qendrën për Punë Sociale në Suharekë , në kuadër të shërbimeve sociale kanë punuar 3 zyrtar të shërbimeve sociale dhe drejtori i qendres .

Kategorit më të theksuar gjatë kësaj periudhe kanë qenë :

- Kërkesa për kontakt prind – fëmijë 1 rast
- Kërkesa për vertetim që nuk iu është hequr zotësia e veprimit dhe nuk gjenden nën kujdestari për sigurimin e lejeve të ndryshme 237 raste
- Kërkesa në Gjykata për mendimin për martesë të parakohëshme -----
- Kërkesë për regjistrim të më vonshëm të fëmijëve të mitur në LAL 1 rast
- Kërkesa për lëshimin e deshmisë se nuk kanë obligime financiare ndaj personave përgjegjës para ligjit – për lirim nga shtetësia e Kosovës 67 raste
- Divizioni i Kundërvajtjes në Suharekë , kërkesa për mendimin për të miturit delikuent për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse si: vjedhje , prishje e rendit dhe qetësi , delikti në komunikacion etj 20 raste
- Gjykata Komunale Suharekë, kërkesë për dhënjen e mendimit për ruajtje, besim dhe edukim për fëmijët e mitur..... 3 raste
- Kërkesa për vertetim për përkujdeje të fëmijëve të mitur Për të bërë bashkim familjarë prind – fëmijë -----
- Stacioni Policor në Suharekë – Raport Policie (kanosje , shkelje e detyrimeve familjare) 1 rast
- Gjykata Komunale në Suharekë , kërkesë për heqjen e zotësisë së veprimit të semuarit mental – mendimi 1 rast
- Gjykata Komunale në Suharekë , kërkesë për dhënjen e mendimit për adoptim -----
- Stacioni Policor në Suharekë – Raport Policor: Dhunë familjare `26 raste
- Policia Regjionale në Prizren – Raport Policor: Dhunim..... 1 rast
- Policia Regjionale në Prizren – Raport Policor: Sulm Seksual 1 rast
- Stacioni Policor në Suharekë – Raport Polior: Tentim-vetëvrasje 1 rast
- Stacioni Policor në Suharekë – Raport Policor: Fëmijë i keqtrajtuar 1 rast

- Stacioni Policor në Suharekë – Raport Policor: Lendim i rendë trupor-vrasje	-----
- Policia Regjionale e Prizrenit – Raport Policor: Keqperdorim i të mitures	1 rast
- Policia Regjionale e Prizrenit – Raport Policor: Tentim – Dhunimi	1 rast
- Kërkesë për caktimin e kujdestarit për të mitur	-----
- Referime interne nga personeli i QPS në Suharekë për asistencën sociale	3 rast
-Kërkesë për strehim në Shtëpinë e të Moshuarve dhe pa përkujdesje në Prishtinë.....	-----
- Kërkesë për strehimin e personit me aftësi të kufizuara dhe i vetmuar	-----
- Kërkesë për strehimin e fëmijut të kertrajtuar	-----
- Kërkesë për vërtetim që është duke u përkujdesur për fëmijën e mitur	1 rast
- Kërkesë për vërtetim për lëshimin e qertifikatës së bashkësisë familjare	-----
- Kërkesë për vërtetim që merr ndihma sociale	-----
- Kërkesë për ndrrim të kujdestarit ndaj të miturve	-----
- Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për të mitur – Mbikqyrje e shtuar nga ana e Organit të Kujdestarisë	3 raste
- Kërkesë për vërtetim që është person i vetmuar dhe i moshuar për të bërë bashkim familjar	11 raste
- Kërkesë për caktimin e kujdestarit për të rritur nga se është i diagnostifikuar me semundje mentale	1 rast
- Kërkesë për pelqim për trashëgimi	4 raste
- Kërkesë për shkarkim të kujdestarit	-----
- Kërkesë për vërtetim për rregullimin e pasaportës për të mitur	1 rast
- Kërkesë për vërtetim për rregullimin e letërnjoftimit	2 raste
- Kërkesë për vërtetim që është i vetmi kujdestar i fëmijut të mitur.....	3 raste
- Kërkesë për fitimin e shtetësisë së Kosovës	8 raste
- Kërkesë për zbatimin e procedurës për pajtim të bashkëshortëve	-----
- Kërkesë për vërtetim që është pa përkujdesje prindërore	1 rast
- Kërkesë për vërtetim për bursë	-----
- Pelqim për udhëtim jashtë vendit për të mitur.....	1 rast

- Kërkesa për përkrahje materiale për familjen që kanë fëmijë me aftësi të përhershme të kufizuar 7 raste

P.S : Prej 2 rasteve 5 është zgjidhur pozitivisht
1 është zgjidhur negativisht dhe
1 plotësim dokumentash
0 nuk janë shqyrtuar akoma

- Pjesëmarrja në seanca gjyqësore për përfaqësim `32 raste

Gjatë kësaj periudhes gjashtë mujore nga data 01.01.2023 e deri me 30.06.2023 zyrtarët e shërbimeve sociale kanë kryer edhe shumë punë të tjera që janë në kontuitet të punës së tyre si vizitat e strehuesve rezidencial si vijon :

1. Qendra e Sigurt për Gra dhe Fëmijë në Prizren 1 rast
 2. Në Entin Special në Shtime (tani janë vetem) 4 raste
 3. Në “SOS Fshatin e Fëmijëve” në Prishtinë 8 raste
 4. Në Shtëpinë për të moshuar në Prishtinë 2 raste
 5. Në Strehim Familjar në Mushtisht -----
 6. Në Strehim në ” Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve” në Prishtinë 0 raste
 7. Shoqata humanitare e gruas me persona të hendikepuar mendor ”Hader” në Prizren 0 raste
- Vizita e fëmijëve me aftësi të përherëshme të kufizuara që duhet të vizitohen dy herë në vit për :
 1. Gjendjen e përgjithëshme shëndetësore të fëmijës
 2. Se përkujdesja e fëmijës nga ana e familjës është
 3. Mjetet materiale të fëmijës shpenzohen vetëm për fëmijën .Gjithësejtë janë vizituar për periudhën Janar – Qershor 2023 81 vizita
 - Vizita e fëmijëve në Strehim Familjar të afërmit 15 vizita

Gjatë kësaj periudhe janë kryar edhe shumë punë të tjera që janë në domenin e shërbimeve sociale si largimin e lypëve (që kërkojnë lëmsh) nga rruga së bashku me policinë si mbajtja e rregulltë e bazës së të dhënave për shërbimet sociale , raportimet e rregullta pran DMS në Prishtinë – në çdo muaj dhe vizitat në SOS – Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës në Prishtinë – çdo muaj . PO ashtu zyrtarët e shërbimit profesional kanë marr pjesë edhe në disa trajnime të organizuar nga institucione të ndryshme, si dhe është bërë konstituimi i Organit të Kujdestarisë pran QPS në Suharekë.

ASISTENCA SOCIALE

Sa i takon Asistences Sociale gjatë këtyre gjashtë muajve të këtij viti pra nga 01.01.2023 deri me 30.06.2023 ka qenë në suaza të normales, kështu:

1. Janar 2023 në Asistencë Sociale ishin 449 familje, me 1947 antar,
2. Shkurt 2023 në Asistencë Sociale ishin 445 familje, me 1930 antar
3. Mars 2023 në Asistencë Sociale ishin 433 familje, me 1850 antar,
4. Prill 2023 në Asistencë Sociale ishin 429 familje, me 1845 antar
5. Maj 2023 në Asistencën Sociale ishin 423 familje, me 1857 antar,
6. Qershor 2023 në Asistence Sociale janë 416 familje me 1811 antar.

Pra në fund të muajit qershor sipas kategorive, në asistencë sociale në kategorinë e parë janë 323 familje me 1316 antar dhe në kategorinë e dytë janë 93 familje me 416 antar, pra gjithsej janë 416 familje në asistencë sociale me 1811 antar.

Gjatë këtyre 6 muajve për herë të parë për asistencë sociale kanë aplikuar 10 familje të cilat të gjitha kanë plotësuar kriterin për Asistencë Sociale pra si që po shifet për çdo muaj kemi raste të reja që aplikojnë. Po ashtu kemi 13 raste të cilat për mosriaplikim janë larguar nga Asistenca Sociale.

Ky shërbim mjaft ka qenë aktiv në zgjidhjen e lendeve të asistencës sociale, dhe familjet në fjalë janë vizituar disa herë, po ashtu gjatë kësaj periudhe ky shërbim ka pasur edhe auditimin, ku janë audituar shumë lende të asistencës, dhe vërejtjet e tyre për një kohë të shkurtër janë eliminuar. Gjatë kësaj periudhe 6 muajve, ky shërbim për nevojat e familjeve në asistencë sociale ka aleshuar 16 vërtetime për familjet që janë shfrytëzues të asistencës sociale dhe 11 familje që nuk janë shfrytëzues.

Nga DPSF- ky shërbim është furnizuar me dy kompjuter të rinj për zyrtarët dhe me 2 aipeda, të cilat zyrtarët e asistencës sociale i kanë në përdorim. Në fillim të muajit maars një zyrtar i këtij shërbimi është pensionuar, kështu në asistencë sociale janë të angazhuar 5 zyrtarë.

	Aktivitetet	Kat: 1	Kat: 2	Gjithsejt:
APLIKIMI	1. Numri i rast. që kanë aplikuar për here të parë	9	1	10
	1.1 Sa prej tyre janë të aprovuar	9	1	10
	1.2 Sa janë në shqyrtim	/	/	/
	1.3 Sa prej tyre janë të refuzuara	/	/	/
RIAPLIKIMI	2. Numri rasteve të larguara për mosriaplikim	11	2	13
	2.1 Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar	129	72	201
	2.1 Numri i rasteve të larguar për mungesë dokum.	32	9	41
VERIFIKIMI	3. Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuar	181	84	265
	3.1 Sa prej tyre janë aprovuar	138	73	211
	3.2 Sa prej tyre janë refuzuar/çregjistruar	43	11	54
KOMIS.MJEKSOR	4. Numri i rasteve të dërguara në Komision mjeksor	120	/	120
	4.1 Numri i rasteve të aprov. nga Komis. mjeksor	98	/	98
	4.2 Numri i rasteve të refuz. nga Komis. mjeksor	22	/	22
	4.3 Num.i rast.të kthira nga K.M. për kompl. e dok.			

Aktivitetët tjera

ANK	5. Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit	9	/	9
-----	---	---	---	---

a) Në shkallë të parë (I)	1	/	1
b) Në shkallë të dytë (II)	8	/	8
5.1 Numri i ankesave të aprovuara	3	/	3
5.2 Numri i ankesave të refuzuara	2		2
5.3 Numri i ankesave në shqyrtim	4	/	4
5.4 Kontestet në Gjykata			
a) Kontestet e pranuar			
b) Konteste të refuzuara			

Kat – I –323 Familje me 1,316 antar

Kat – II –93 Familje me 495 antar

Gjithsej Kat I + Kat II – 416 Familje me 1,811 antar

Komentët:

Vërtetima: 16 Vërtetima që janë shfrytzues të Asistencës Sociale si dhe 11 që nuk janë shfrytzues të Asistencës Sociale .